



UNITED NATIONS  
KOSOVO TEAM



## Raporti për Rezultatet 2021

Korniza e Kombeve të Bashkuara për  
Bashkëpunim për Zhvillim të  
Qëndrueshëm 2021-2025



# Përmbajtja:

Parathënie	1
Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë	2
Partnerët kyç zhvillimorë të OKB-së në Kosovë	3
1. Zhvillimet kyçe në Kosovë dhe konteksti rajonal	4
2. Mbështetja e sistemit zhvillimor të OKB-së për prioritetet zhvillimore të Kosovës	7
2.1. Sigurimi i rezultateve për Kosovën9 Fusha prioritare 1 Fusha prioritare 2 Fusha prioritare 3 Fusha prioritare 4 Fusha prioritare ndër-sektoriale 5	9
2.2. Mbështetja e partneriteteve dhe financimi për Agjendën 2030	27
2.3. Rezultatet nga puna më e madhe dhe e kryer mirë së bashku nga OKB-ja: koherenca, efektshmëria dhe eficaenca e OKB-së	30
2.4. Pasqyra financiare dhe mobilizimi i resurseve	32
3. Fokusi kyç i UNKT-së për vitin e ardhshëm	34

# Parathënie

Viti 2021 ishte i dyti vit me radhë nën hijen e COVID-19, por gjatë tij u pa një periudhë rezilience përballë sfidave të paprecedentë, dhe Kosova<sup>1</sup> hyri bindshëm në rrugën drejt rimëkëmbjes duke i sfiduar parashikimet.

Teksa kujtojmë me dhimbje njerëzit që humbën jetën nga virusi në Kosovë gjatë vitit 2021, në të njëjtën kohë jemi mirënjohës që reagimet e fuqishme rezultuan efektive në kufizimin e humbjeve të mëtejshme, parandalimin e kolapsit të sistemit shëndetësor dhe zbutjen e dëmeve socio-ekonomike të shkaktuara nga masat kufizuese. Kombet e Bashkuara janë krenare që kanë kontribuar në këto suksese në bashkëpunim të ngushtë me qeverinë dhe partnerët e tjerë. Në luftën tonë të përbashkët kundër COVID-19 dhe pasojave të tij, dhe në përpjekjet tona të përbashkëta për ta mbështetur qeverinë, ne ndihmuam në zgjerimin e kapaciteteve të testimit, shpërndarjen e pajisjeve jetike dhe trajnimin e stafit të kujdesit shëndetësor. Resurset u mobilizuan përmes burimeve të ndryshme për t'i rritur sinergjitë në tejkalimin e ndikimeve shumështrësore të pandemisë.

Deri në fund të vitit, 53.8 për qind e popullatës në moshë vaksinimi ishin vaksinuar me dy doza, 21 për qind përmes vaksinave të dhuruara nga mekanizmi COVAX i lehtësuar nga OKB-ja. Por mbështetja jonë nuk përfundon me kaq. Duke u fokusuar në më të cenueshmit, programet e vizitave në shtëpi të mbështetura nga OKB-ja trajtuan mbi 15,000 fëmijë dhe 2,500 gra shtatzëna. Ndihma jonë kontribuoi që shkollat të jenë të sigurta për mbi 300,000 nxënës dhe zvogëloi riskun e braktisjes së shkollës nga vajzat. Këshillat tona e ndihmuam qeverinë t'i mbrojtë gratë e prirura për cenueshmëri nga efektet më shkatërruese ekonomike përmes përfshirjes së masave të targetuara në paketën e qeverisë për rimëkëmbjen, ndërkohë që përdorimi

inovativ i një sistemi për kuponë, subvencione dhe masa të tregut aktiv të punës solli përfitime të drejtpërdrejta për më shumë se 10,000 familje dhe më shumë se 1,700 punëkërkuës. Ne dhamë alarmin për mundësinë e rritjes së dhunës në familje të shkaktuar nga karantina dhe ndihmuam në sigurimin e disponueshmërisë së vazhdueshme të shërbimeve.

Për OKB-në, viti 2021 shënoi edhe vitin e parë të zbatimit të Kornizës sonë për Bashkëpunim për Zhvillim të Qëndrueshëm 2021-2025, një moment historik i rëndësishëm që i dëshmon për marrëdhëniet e ngushta ndërmjet Kombeve të Bashkuara dhe qeverisë dhe popullit të Kosovës. Gjatë gjithë vitit 2021, ne siguroam rezultate të prekshme në pesë fusha prioritare, duke i bashkuar agjencitë për të siguruar reagim më efektiv dhe të integruar me partnerët për luftimin e pandemisë dhe hapjen e shtigjeve drejt rimëkëmbjes reziliente.

Gjatë vitit 2021 u pa progres mbresëlënës në barazinë gjinore në Kosovë në fushat e dhunës në familje dhe buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, dhe më vjen shumë mirë kur shoh që udhëheqës të industrive, si Kryeshafi Ekzekutiv i Meridian Corporation, i përfshijnë dimensionet e barazisë gjinore në vendet e punës brenda korporatave, duke u përkushtuar publikisht ndaj Parimeve të OKB-së për Fuqizimin të Grave. Dëshmuam edhe aprovimin e një plani të veprimit të qeverisë për të drejtat dhe liritë e njeriut dhe miratimin e shtatë planeve komunale për pjesëmarrje më të madhe të popullit të Kosovës në formulimin, planifikimin dhe zbatimin e politikave lokale. Përmes Qendrës të pritjes dhe regjistrimit të hapur kohët e fundit, autoritetet do ta kenë më të lehtë t'i mbështesin migrantët e bllokuar në Kosovë, dhe falë një grupi të ri udhëzimesh do t'i mbrojnë më mirë fëmijët migrantë. Procesi në vazhdim për zhvillimin e Strategjisë së parë të Kosovës për Zhvillim të Turizmit të Qëndrueshëm dhe Udhërrëfyesit për Ekonominë Qarkore, shpreh shpresa të mëdha për iniciativat e

ardhshme për krijim të vendeve të punës, ndërsa hapja e qendrës së parë zyrtare për certifikim të përkthyesve në Prishtinë promovon në mënyrë aktive shumëgjuhësinë dhe rritjen e kohezionit social. Duke e këshilluar qeverinë për zotimet për garancitë për të rinjtë, ne i kemi ndihmuar Kosovës t'i afrohet synimit për t'i ofruar çdo të riu punësim, trajnim apo arsimim cilësor, duke e aktivizuar plotësisht potencialin demografik të Kosovës. OKB-ja ka punuar edhe që të dëgjohet zëri i qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile të Kosovës për tema me interes global, qoftë përmes fushatës së përbashkët për veprim për klimën në kontekstin e COP 26 apo debatit lokal mbi rolin qendror të sistemeve ushqimore të Kosovës për sigurimin e ushqimit të shëndetshëm dhe të sigurt për të gjithë.

Përkundër pengesave të paraqitura nga pandemia, ne vazhduam të punojmë nga afër me Zyrën për Planifikim Strategjik të Kryeministrit për përafrimin e Strategjisë së ardhshme Zhvillimore të Kosovës 2030 me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Të udhëhequr nga Agjenda e Përbashkët e OKB-së dhe të frymëzuar nga rezultatet e arritura deri më tani, presim me padurim vitin 2022 – për një bashkëpunim gjithnjë e më të ngushtë me qeverinë dhe popullin e Kosovës, dhe me vizion të përbashkët për të nxitur prosperitetet afatgjatë për të gjithë.

Përballë vështirësive, ne treguam se çfarë mund të arrijë solidariteti, multilateralizmi dhe veprimi i bazuar në dëshmi. Le të investojmë në një të ardhme gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme të drejtuar nga politika të integruara dhe veprime me ndikim që i vendosin qytetarët në qendër të të gjitha përpjekjeve tona, duke mos lënë askënd pas!



Ulrika Richardson

Koordinatorë për Zhvillim e OKB-së

<sup>1</sup> Referencat për Kosovën do të kuptohen në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999).

# Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

*I kryesuar nga Koordinatorja për Zhvillim e Kombeve të Bashkuara, e cila është përfaqësuesja e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara e caktuar për operacionet zhvillimore në Kosovë, Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNKT) përbëhet nga 15 agjenci, fonde dhe programe rezidente dhe një jorezidente të Kombeve të Bashkuara, dhe është i lidhur ngushtë me Bankën Botërore.*

- UNKT-ja përbëhet nga këto subjekte:
  - 15 Agjencitë, fondet dhe programet e Kombeve të Bashkuara me zyrë ose staf në Kosovë
  - Një subjekt i përfaqësuar përmes zyrës së vet rajonale.
  - I lidhur me Bankën BotëroreUNKT-ja e koordinon punën dhe aktivitetet e veta me Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) përmes një Kornizë të përbashkët të Integruar Strategjike të nënshkruar në maj 2021.
- UNKT-ja koordinohet nga Koordinatorja për Zhvillim e Kombeve të Bashkuara dhe ekipi i saj. Ekipi e mbështet plotësisht dhe punon drejt realizimit të prioritetëve zhvillimore të Kosovës dhe agjendës së integritimit në BE, si dhe përkushtimit të Kosovës për arritjen e Agjendës 2030 dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ).
- Duke i bashkuar avantazhet krahasuese të subjekteve të ndryshme të Kombeve të Bashkuara nën Kornizën e Kombeve të Bashkuara për Bashkëpunim për Zhvillim të Qëndrueshëm 2021-2025, UNKT-ja ofron mbështetje të përshtatur për të adresuar nevojat e më të cenueshmeve, të pafavorizuarve dhe atyre që janë në risk të mbeten prapa në Kosovë.
- Përveç 15 agjencive të OKB-së të pranishme në Kosovë, në punën e

UNKT-së kontribuojnë edhe UNEP dhe UNESCO.

- Korniza e rezultateve të Kornizës për Bashkëpunim 2021-2025 përshkruan katër rrjedhoja dhe një fushë ndërsektoriale që u përgjigjen nevojave të Kosovës dhe shfrytëzojnë avantazhet krahasuese të OKB-së. Rrjedhojat bëhen operacionale përmes Planeve të përbashkëta Vjetore të Punës.

## Agjencitë rezidente të OKB-së:



Food and Agriculture Organization  
of the United Nations



International  
Labour  
Organization



IOM  
UN MIGRATION



UNITED NATIONS  
HUMAN RIGHTS  
OFFICE OF THE HIGH COMMISSIONER



UNDSS



UNFPA



UN HABITAT  
FOR A BETTER URBAN FUTURE



UNHCR  
The UN Refugee Agency



UNODC  
United Nations Office on Drugs and Crime



unicef



UNOPS



UN  
VOLUNTEERS



UN  
WOMEN



World Health  
Organization  
REGIONAL OFFICE FOR  
Europe

## Agjencitë rezidente të OKB-së:



UN  
environment  
programme

## Institucionet Financiare Ndërkombëtare



THE WORLD BANK



## Partnerët kyç zhvillimorë të OKB-së në Kosovë

6. Për zbatimin e Komizës për Bashkëpunim, partnerët kyç të UNKT-së janë qeveria, përkatësisht Zyra për Planifikim Strategjik e Kryeministrit dhe ministrinë e linjës, institucionet e pavarura dhe qeverisja lokale, partnerët zhvillimorë, organizatat e shoqërisë civile dhe sektori privat. Zbatimi mbikëqyret nga pesë Grupe për Rezultatet e Rrjedhajoje, secili i bashkë-kryesuar nga krerët e dy agjencive të OKB-së, me pjesëmarrje nga qeveria relevante dhe partnerë të tjerë.
7. Komiza për Bashkëpunim ka përafrim të fortë me prioritetet e qeverisë, çka pasqyrohet në angazhimin e vazhdueshëm të UNKT- së

me institucionet përmes këshillave për integrimin e OZHQ-ve në zhvillimin e dokumenteve strategjike me spektër të gjerë, siç janë Strategjia Kombëtare për Zhvillim, Udhërrëfyesi për Ekonominë Qarkore, Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë, ose Strategjia për Zhvillim të Turizmit të Qëndrueshëm. Këshillat e UNKT-së kanë qenë gjithashtu kyçe për finalizimin e Programit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut 2021-2025, Strategjisë për Migracionin 2021-2025 dhe Strategjisë për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026, e cila u miratua përfundimisht në janar 2022. Mbështetja e OKB-së për zbatimin e Deklaratës së Ballkanit Perëndimor për sigurimin e integritetit të qëndrueshëm të të rinjve në tregun e punës, të 8 korrikut 2021,



Artist: Peter Hanley & Alvaro Urbano Artwork: Project Me Not 2021  
©Autostudio, Biennale, 2021

8. U forcan partneritetet për ta mbështetur popullin e Kosovës për tejkalimin e pandemisë. Si pjesë e komisionit të vaksinimit kundër COVID-19, të themeluar nga Ministria e Shëndetësisë, dhe duke ofruar këshilla strategjike për targetimin dhe realizimin e 15 masave për rimëkëmbje ekonomike, Kombet e Bashkuara kanë luajtur rol kritik me ndihmën që i kanë dhënë Kosovës që t'i mbështesë më të cenueshit dhe t'i vendosë të drejtat e njeriut në qendër të reagimit dhe rimëkëmbjes.
8. Nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe, OKB-ja ka punuar edhe në fusha si: reduktimi i ndotjes së ajrit (Luksemburgu), promovimi i vetëdijesimit të publikut për krizën klimatike (Austria, Italia dhe MB), siguria dhe shëndeti në punë (Suedia), ngritja e kapaciteteve në mbështetje të agjendës së integritetit në BE (Norvegjia), parandalimi i punës së fëmijëve (SHBA), përfshirja sociale (Kanadaja dhe MB) dhe të tjera

Nëpërmjet zbatimit të prioritetëve të financuara nga Instrumenti i BE-së për Asistencën e Para-Anëtarësimit, UNKT-ja i zhvilloi më tej prioritetet në përgjigjen socio-ekonomike ndaj krizës COVID-19, menaxhimin e migracionit, trajtimin e ujërave të zeza, edukimin, eliminimin e dhunës ndaj grave, mes plot fushave të tjera.

9. U zgjeruan partneritetet private me bankat, bizneset dhe kompanitë e teknologjisë, për të zgjeruar përdorimin e teknologjive digjitale për të mundësuar qasje në arsim, shërbime sociale dhe mjekësore gjatë gjithë pandemisë, me fokus të veçantë tek komunitetet e prekura.

### Partnerë kyç dypalësh

- Austria
- Bashkimi Evropian
- Kanadaja
- Finlanda
- Gjermani
- Italia
- Japonia
- Kosova
- Luksemburgu
- Norvegjia
- Suedia
- Zvicra
- Mbretëria e Bashkuar
- SHBA



Kapitulli 1:

## Zhvillimet kyçe në Kosovë dhe konteksti rajonal





# Zhvillimet kyçe në Kosovë dhe konteksti rajonal

*Ekonomia me të hyra të mesme të larta e Kosovës përjetoi rimëkëmbje të fortë në vitin 2021, të nxitur nga masat efektive fiskale dhe rritja e përtërirë.*

*Shumica qeverisëse dhe besimi i demonstruar i publikut në përmbushjen e premtiveve kundër korrupsionit, kanë krijuar njëfarë stabiliteti institucional dhe mundësi për avancim të reformave. Në përgjithësi, ndikimi shëndetësor i COVID-19 ka qenë i moderuar, por duhet t'i kushtohet vëmendje cënueshmërive socio-ekonomike para-ekzistuese që zgjerojnë hendekët e pabarazisë dhe regresionet në kohezionin social.*


- Viti 2021, i dytë vit me radhë i shënuar nga pandemia, solli vazhdimin e sfidave serioze ekonomike dhe sociale për Kosovën. Edhe pse aktiviteti ekonomik ishte tkurrur për 5.3 për qind në vitin 2020 për shkak të masave për kufizimin e pandemisë, ekonomia u ringrit në vitin 2021 pjesërisht për shkak të masave të suksesshme fiskale dhe mbështetjes të pakrahasueshme në rajon nga diaspora, duke çuar në rimëkëmbje të vlerësuar prej mbi 7 për qind.
- Në përgjithësi, ndikimi shëndetësor i COVID-19 në Kosovë ka qenë i moderuar, pasi autoritetet vepruan shpejt për ta frenuar virusin me mbështetje vendimtare nga komuniteti ndërkombëtar. Sidoqoftë, vuajtjet e mëdha njerëzore prej pandemisë pasqyrohen në totalin prej 1,655 vdekjesh nga COVID-19 gjatë gjithë vitit, dhe rritja shqetësuese e infektiveve gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021, e cila vazhdoi të sillte shtrëngesa të mëdha për institucionet publike.
- Aftësia e autoriteteve për reagim adekuat u forcua nga elementi i

stabilitetit politik i sjellë nga shumica e fortë parlamentare e qeverisë e fituar në zgjedhjet e shkurtit 2021. Në korrik 2021, qeveria shpalli një paketë për rimëkëmbje socio-ekonomike prej 420 milionë eurosh për të mbështetur sektorin e shëndetësisë, bizneset, bujqësinë, proceset arsimore, mirëqenien sociale, inovacionin dhe punësimin e grave, ndër të tjera.

- Megjithatë, për shkak të cënueshmërive para-ekzistuese socio-ekonomike në sistemet shëndetësore dhe të mbrojtjes sociale të Kosovës dhe efekteve potencialisht shkatërruese të mbylljes së përsëritur të shkollave që veçse kishin nivele të ulëta arsimore, janë rritur

gjasat për zgjerim të hendekëve të pabarazisë dhe regresioneve në kohezionin social. Me fillimin e rritjes së çmimeve të konsumit në gjysmën e dytë të vitit 2021, mbi grupet më të cënueshme filluan të shfaqen presionet inflacioniste. Pandemia ka përkeqësuar edhe situatën për migrantët, azilkërkuesit dhe refugjatët që tranzitojnë rrugës për në Evropën Perëndimore, duke përfshirë pothuajse 5,000 afganë që ikën nga pushtimi i talebanëve në gusht 2021, të cilët u pritën nga qeveritë e Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës.

*Gratë fituan 43 nga 120 ulëse në Kuvend në zgjedhjet e shkurtit 2021, nga 38 ulëse në zgjedhjet e tetorit 2019. Kuota kushtetuese është 36 ulëse për gratë.*




- Zgjedhjet e vitit 2021 shënuan njëkohësisht rritje të vizibilitetit për gratë politike dhe theksuan rrugën e gjatë përpara drejt mundësive të barabarta.

Gratë e tejkaluan kuotën gjinore prej 30 për qind në Kuvend dhe fituan poste ekzekutive të nivelit të lartë. Sidoqoftë, në nivel komunal gratë mbeten jashtëzakonisht të nënpërfaqësura.

16. Statusi i Kosovës vazhdon ta ndajë rajonin – dhe komunitetin ndërkombëtar – mes atyre që e njohin Kosovën dhe atyre që nuk e njohin. Situata në Kosovë mbetet në agjendën e Këshillit të Sigurimit. Rifillimi i dialogut Beograd-Prishtinë të ndërmjetësuar nga BE-ja çoi në dy takime të nivelit të lartë në vitin 2021 dhe negociata në nivel teknik, por me rezultate të kufizuara. Perspektiva e integritimit në BE vazhdon të jetë një shtytës i rëndësishëm socio-ekonomik në Kosovë si në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Në raportin e tij të fundit të progresit për vitin 2021, Komisioni Evropian vuri në dukje miratimin nga qeveria të Agjendës së Reformave Evropiane në tetor 2021 si një “trend pozitiv i përkushtimit të ripërtëritë të Kosovës ndaj reformave të ndërlidhura me BE-në”. Megjithatë, shumë qytetarë në Kosovë dhe rajon perceptojnë se ka mungesë të progresit dhe perspektivës, veçanërisht për shkak të vonesave në procesin e liberalizimit të vizave dhe bllokimit të vitit 2021 për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.

17. Një mjet i rëndësishëm për Kosovën për të adresuar sfidat socio-ekonomike do të jetë përmes veprimeve të financuara nga Instrumenti i ri i Para-Anëtarësimit për periudhën 2021-2027 (IPA III) i miratuar nga Parlamenti Evropian në shtator 2021, në të cilin Kosova ka të drejtë të aplikojë. Mjeti kryesor financiar për zbatimin e IPA III, Plani Ekonomik dhe i Investimeve për Ballkanin Perëndimor dhe Agjenda e Gjelbër përkatëse, tashmë po udhëheq drejtimin strategjik në fushat e zhvillimit të qëndrueshëm, tranzicionit të gjelbër dhe transformimit digjital. Në tetor 2021, udhëheqësit e BE-së dhe të Ballkanit Perëndimor nënshkruan Planin e Veprimit të Agjendës së Gjelbër në samitin BE-Ballkani Perëndimor në Brdo pri Kranju në Slloveni.



Burimi:  
 Agjencia e Statistikave të Kosovës; UNDP,  
 Banka Botërore, Fondacioni Heritage;  
 Reporterët pa Kufij; Transparency  
 International; Freedom House.



## Kapitulli 2:

### Mbështetja e sistemit zhvillimor të OKB-së për prioritetet zhvillimore të Kosovës





## Mbështetja e sistemit zhvillimor të OKB-së për prioritetet zhvillimore të Kosovës

Trajektorja e zhvillimit të Kosovës mbetet e ndërthurur fort me progresin drejtë aspiratave të saj për integrim në BE, dy fusha të rëndësishme që plotësojnë njëra-tjetrën dhe krijojnë sinergji. Shtatë vjet pas miratimit të Agjendës 2030, Strategjia e ardhshme Kombëtare për Zhvillimit 2030 ofron një mundësi kritike. UNKT-ja ka vazhduar t'i këshillojë institucionet se si të përfshijnë OZHQ-të në dokumentet strategjike.

18. Një [raport i përbashkët nga UNKT-ja dhe Zyra e BE-së](#) korrikut 2021 tregoi se **avancimi drejt OZHQ-ve do t'i ndihmojë Kosovës të përparojë drejt integrimit në BE.**

- Përdorin dëshmi dhe të dhëna për të nxitur veprime;
- Forcojnë rolin e institucioneve qendrore, qeverisjes lokale dhe akterëve të tjerë për të siguruar koordinim dhe planifikim afatgjatë në të gjitha nivelet;
- Përmirësojnë koherencën e politikave BE-OZHQ në të gjitha proceset qendrore të vendimmarrjes;
- Ndërtojnë dhe shkëmbejnë njohuri.



Skano për më shumë

Një krahasim mes kapitujve të *acquis* të BE-së dhe OZHQ-ve, tregon përafrim prej mbi 60 për qind.

Raporti përmban një listë me 10 rekomandime për Kosovën dhe institucionet e BE-së, si dhe palët e tjera të interesit, për të ndihmuar në përshejtimin e arritjes së OZHQ-ve duke rritur sinergjitë me kërkesat për anëtarësim në BE përmes masave që:

## 19. Një tjetër shqyrtim i UNKT-së 2021



Skano për më shumë


matë se deri në çfarë mase janë përafruar dokumentet strategjike të Kosovës me OZHQ-të:

- 66% e dokumenteve strategjike janë përafruar plotësisht me OZHQ-të, duke përfshirë të gjitha caqet për OZHQ4 (arsimi) dhe OZHQ16 (qeverisja gjithëpërfshirëse), së bashku me 89% të atyre për OZHQ5 (gjinia), 88% për OZHQ9 (infrastruktura dhe industrializimi) dhe 85% për OZHQ3 (shëndeti). Ato që kanë mbetur me përafrim të vogël përfshijnë caqet për OZHQ17 (partneritetet), OZHQ2 (zero uri), OZHQ6 (ujë i pastër), OZHQ12 (konsum i përgjegjshëm), OZHQ13 (veprim për klimën).
- EUROSTAT ka filluar të raportojë për Kosovën në lidhje me disa tregues të OZHQ-ve, duke ofruar të dhëna të rëndësishme por jo të plota:

- Pothuajse nuk ka të dhëna për OZHQ-të 10, 11, 12, 13, 14; dhe ka hendekë të të dhënave për OZHQ-të 2, 6, 9, 15.
  - Mbledhja rutinore e të dhënave është e kufizuar, dhe mungojnë të dhënat e serive kohore dhe të zbërthyer për të monitoruar progresin dhe për të identifikuar hendekët e ekuitetit.
  - Strategjia e ardhshme Kombëtare për Zhvillim 2030 do ta pasqyrojë më mirë tërësinë e Agjendës 2030.
20. OKB-ja e vazhdoi mbështetjen e vet teknike për **Këshillin të Qëndrueshëm, i cili në vitin 2021 miratoi një plan të ri pune, duke përcaktuar se si do ta mbikëqyrë zbatimin e Strategjisë së ardhshme për Zhvillim Kombëtar të fokusuar në OZHQ, si dhe duke filluar krijimin e një paneli kontrolli për të monitoruar progresin drejt OZHQ-ve. Në dhjetor 2021, me mbështetjen e OKB-së, Këshilli organizoi një tryezë të rumbullakët mbi treguesin 5.c.1 të OZHQ-ve për ndarjet buxhetore publike për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave. Këto janë momente historike të rëndësishme në rrugën e**

## Përafrimi i përgjithshëm i politikave me OZHQ-të

- Përafruar plotësisht
- Përafruar
- pjesërisht
- Nuk është përafruar





## 2.1. Sigurimi i rezultateve për Kosovën

- Ky Kapitull 2 thekson kontributet e dhëna nga UNKT-ja në vitin 2021 në bashkëpunim të ngushtë me qeverinë dhe partnerët e tjerë, veçanërisht rezultatet e arritura në kuadër të Kornizës së vet për Bashkëpunim dhe përpjekjeve për luftimin e pandemisë dhe rimëkëmbjen prej saj.
- [Korniza e Kombeve të Bashkuara për Bashkëpunim për Zhvillim të Qëndrueshëm 2021-2025](#) shërben si themeli i programimit dhe intervenimeve zhvillimore të UNKT-së për ta mbështetur më së miri rrugën e rritjes zhvillimore të Kosovës gjatë pesë viteve të ardhshme. Korniza është e lidhur ngushtë me prioritetet e qeverisë, duke përfshirë Planin e Qeverisë 2021-2023 dhe Strategjinë e ardhshme Kombëtare për Zhvillim 2030. Zbatimi filloi në janar 2021.
- Rezultatet kolektive të arritura gjatë këtij viti të parë të zbatimit në pesë fushat prioritare përfaqësojnë një shembull të fortë të reformës së OKB-së në veprim, duke bashkuar agjencitë e Kombeve të Bashkuara për të siguruar një përgjigje më efektive dhe të integruar për luftimin e pandemisë dhe për krijimin e shtigjeve drejt rimëkëmbjes reziliente.

### 5 FUSHAT PRIORITARE:



Qeverisja  
Llogaridhënese



Shërbime dhe politika sociale  
gjithëpërfshirëse dhe jo-diskriminuese



Zhvillimi ekonomik  
resilient, i qëndrueshëm  
dhe gjithëpërfshirës




Kohezioni Social



Tema ndër-sektoriale: rritja e  
barazisë gjinore dhe e  
pjesëmarrjes, fuqizimit dhe  
angazhimit qytetar të bartësve  
të të drejtave



Skano për më shumë





# Rezultatet Kyçe

## Fusha Prioritare 1

### Qeverisje Llogaridhënese



Përafrimi me OZHQ-të



Përafrimi me Programin e Qeverisë së Kosovës

2.2 2.3 2.4

Përafrimi me Kapitujt e Integritimit në BE dhe Fushat Prioritare

5 16 19 23

## Rrjedhoja 1:

Deri në vitin 2025, të gjithë qytetarëve të Kosovës, femra dhe meshkuj, u shërbejnë institucione më llogaridhënese, efektive, transparente dhe me përgjegjshmëri gjinore në të gjitha nivelet, duke siguruar qasje në drejtësi, barazi dhe pjesëmarrje për të gjithë

	2019 (niveli bazë)	2021	Trendi
<b>Rrjedhoja 1.1</b> Perceptimi i qytetarëve për kënaqshmërinë me punën e institucioneve të Kosovës	<b>22%</b> Burra: 18.6% Gra: 20.7% K-Shqiptarë: 17.8% Serbë të Kosovës: 3.2% Tjerë: 20.9%	<b>51.4%</b> Burra: 60.4% Gra: 61.1% Shqiptarë: 62.7 % Serbë të K.: 3% Tjerë: 61.5%	
<b>Rrjedhoja 1.2</b> Perceptimi i qytetarëve që besojnë se vendimmarrja në institucionet e Kosovës është gjithëpërfshirëse dhe reaguese	<b>6.75%</b> Burra: 5.9% Gra: 7.5% Shqiptarë: 6% Serbë të Kosovës 20.7% Tjerë: 6.2%	<b>20.1%</b> Burra: 20.2%, Gra: 19.8%, Shqiptarë: 18.8%, Serbë të K.: 19.1%, Tjerë: 21.9%	
<b>Rrjedhoja 1.3</b> Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike	<b>53.79%</b> Gra: 47.11% Burra: 5.9% Gra: 7.5% Shqiptarë: 6% Serbë: 20.7% Tjerë: 6.2%	Të dhënat në pritje	N/A

**Rrjedhoja 1.4**  
Vlera e Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit

**36**  
(101 nga 180)

**39**  
(87 nga 180)



**Rrjedhoja 1.5**  
Vlera e aseteve kriminale të ngrira, të sekuestruara dhe të konfiskuara

Vlera e aseteve të konfiskuara:  
€ 991,593

Vlera e aseteve të konfiskuara  
€ 5,210,528



**Rrjedhoja 1.6**  
Numri i personave/rasteve që përfitojnë nga qasja në drejtësi

650 raste OSHC-të, 5,539 Agjencia e Ndhmës Juridike Falas

343 raste (të limituara për shkak të kufizimeve ndaj COVID-19)



**Rrjedhoja 1.7**  
Përqindja e rekomandimeve të lëshuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) të zbatuara nga autoritetet

34%

37%



**Rrjedhoja 1.8**  
Përqindja e grave në pozita vendimmarrëse në nivel qendror dhe lokal

Zgjedhjet e përgjithshme 2019  
32% gra deputete  
33% gra ministre

Zgjedhjet e përgjithshme 2020  
36% gra deputete  
33% gra ministër



Zgjedhjet lokale 2019  
0% gra kryetare  
36% përfaqësim

Zgjedhjet lokale 2021  
5% gra kryetare  
33% përfaqësim

**Rrjedhoja 1.9**  
Përqindja e qytetarëve që ndihen të sigurt dhe me siguri

**75.60 %**  
Burra: 71.4%  
Gra: 72.9%  
Shqiptarë: 71%  
Serbë të K.: 21.6%  
Tjerë: 58%

76.4%  
Burra: 76%  
Gra: 76.7%  
Shqiptarë: 76.4%  
Serbë të K.: 34.8%  
Tjerë: 85%



**Rrjedhoja 1.10**  
Ekzistenca e sistemeve funksionale që i gjurmojnë dhe bëjnë alokime publike për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave

Nuk është vendosur

Nuk është vendosur

Burimet: Pulsi Publik i UNDP-së, Transparency International

24. IOM-i dhe UNDP-ja mbështetën **gjithëpërfshirjen në institucionet lokale** duke ndërtuar kapacitetet e tyre për përbushjen e **kërkesave gjuhësore** dhe për sigurimin e **qasjes në shërbime dhe informata për të gjitha komunitetet.**

- Një **program i ri-akredituar BA në Ballkanistikë** në Universitetin e Prishtinës, i cili regjistroi studentët e tij të parë në shtator, do të prodhojë në vazhdimësi përkthyes profesionistë të gjuhëve zyrtare të Kosovës, duke përmirësuar komunikimin ndër-gjuhësor dhe kulturor në Kosovë dhe rajon.
- Një qendër gjuhësore u krijua në Universitetin e Prishtinës për të shërbyer **si institucion qendror certifikues për përkthyes dhe interpretë profesionistë**, duke ofruar gjithashtu kurse të gjuhëve zyrtare për studentët, nëpunësit publikë dhe popullatën e gjerë.
- **Gjykata Themelore në Prishtinë** u bë gjykata e parë me një **zyrë të përkthimeve** të krijuar për të lehtësuar qasjen në drejtësi për ata që nuk flasin shqip.
- **78 përkthyes dhe interpretë të gjykatës** morën trajnime të përshtatura gjuhësore në shqip dhe serbisht dhe gjithsej **133 praktikues ligjorë** (50% gra) përfituan nga zhvillimi i kapaciteteve.

25. UN-Habitat dhe UNDP bashkëpunuan me **komunat** për ngritjen e kapaciteteve të tyre për t'u bërë **më gjithëpërfshirëse dhe transparente** dhe për të promovuar **demokraci më të forta lokale:**

- Kuvendi komunal i Mitrovicës së Veriut miratoi **Planin** e parë për **Pjesëmarrje të Komunitetit** me mbështetjen e UN-Habitat, duke kompletuar kornizat e politikave për pjesëmarrjen në të shtatë komunat e rajonit të Mitrovicës.
- Zhvillimi i dokumenteve të planifikimit hapësinor, planeve sektoriale dhe projekteve të tjera për investime kapitale, u bazua në konsultimet publike në komuna dhe fshatra, ku u dëgjuan zërat e banorëve të zakonshëm, shoqërisë civile, studentëve dhe palëve të tjera lokale të interesit. Qytetarëve iu dha mundësia të **formësojnë të ardhmen e komuniteteve të tyre**, duke nxitur ndjenjën e përkatësisë dhe të pronësisë mbi zhvillimin e komunave.



© UN-Habitat, 2021



© UNDP, 2021.

- lokale të interesit. Qytetarëve iu dha mundësia të formësojnë të ardhmen e komuniteteve të tyre, duke nxitur ndjenjën e përkatësisë dhe të pronësisë mbi zhvillimin e komunave.
- Udhëzimet për planet për lëvizshmëri të qëndrueshme urbane që targetojnë komunat e Kosovës dhe të publikuara nga UN-Habitat, ofruan udhëzime të rëndësishme se si të zhvillohen sisteme të qëndrueshme të transportit urban. Disa muaj më vonë, komuna e Mitrovicës së Jugut ishte një nga tre finalistët për edicionin e dhjetë të Çmimeve për Planifikim të Lëvizshmërisë së Qëndrueshme Urbane të ndara nga Komisioni Evropian për masat e planifikuara për parandalimin e aksidenteve, planin e menaxhimit të



**Plani Zhvillimor i Komunitetit i zhvilluar me mbështetjen e UN-Habitat, na lejoji të kryejmë aktivitete të përshtatura me nevojat dhe prioritetet TONA. Arritëm të forconim edukimin informal dhe të organizonim tubime të rinjve, aktivistëve lokalë, adhuresve të natyrës. Përkushtimi i përbashkët i shoqërisë civile dhe qeverisjes lokale të marra së bashku, mund të kontribuojnë në mënyrë më efektive në zhvillimin afatgjatë të komunitetit.**



**Qasja në drejtësi dhe sundimi i ligjit**

parkimeve dhe opsionet e përmirësuar të transportit publik.

- 117 të rinj nga të gjitha komunitetet etnike të Kosovës, 60% e tyre femra, u bënë **mbrojtës të të drejtave të njeriut** me mbështetjen e UNDP-së.
- 26. Në korrik, Ministria e Drejtësisë lansoi **Strategjinë e parë të Kosovës për Sundimin e Ligjit 2021-2026**, bazuar në gjetjet nga Rishikimi Funkcional i Sundimit të Ligjit i finalizuar me mbështetjen e UNDP-së.
- 27. Njëpërmjet një klinike mobile të operuar nga Agjencia për Ndhimë Juridike Falas me mbështetjen e UNDP-së, **280 persona** (164 prej tyre gra) **përfituan ndihmë juridike dhe asistencë** në procedurat zyrtare dhe ligjore. 123 individë nga **komunitetet rom,**



—Z. Bojan Milosavljeviq  
Drejtor Ekzekutiv i Asociacionit për Zhvillim Social dhe Ekonomik, Leposaviq







## Mbrojtja e njerëzve në lëvizje

**ashkali dhe egjiptas** (74 gra) përfituan nga ndihma juridike e ofruar nga UNHCR-ja për procedimin e regjistrimit të tyre civil. **145 të kthyerve vullnetarë dhe personave të zhvendosur** (56 gra) iu dha ndihmë juridike për të fituar qasje në arsim, ndihmë sociale, pronë dhe të drejta pensionale.

28. Një furrë buke në Qendrën Korrektuese për Gra dhe të Mitur në Lipjan e themeluar nga UNMIK-u përmes UNOPS-it në bashkëpunim me EULEX-in, e përdor në mënyrë inovative konceptin e ndërmarrjes sociale. Fitimet nga furra e bukës kthehen përsëri në Qendër, duke rritur pavarësinë financiare të institucionit dhe nga ana tjetër duke rritur mirëqenien e të burgosurve. UNDP-ja kontribuoi duke siguruar certifikimin e trajnimit profesional për të burgosurit e punësuar përmes furrës së bukës, duke u ofruar atyre perspektiva të vlefshme për riintegrim të suksesshëm në shoqëri në të ardhmen.

28. Me mbështetjen e UNDP-së, Akademia e Drejtësisë e Kosovës ka hartuar **Manualin Trajnues për Bashkëpunëtorët Juridikë Profesionalistë**.
29. Në tetor 2021, qeveria miratoi “Programin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut 2021–2025” dhe Planin e Veprimit përkatës, mbi të cilin UNMIK/OHCHR dha komente teknike.

### UN-Habitat dhe UNMIK u bashkuan për të promovuar vlerësimet e bazuara në të dhëna në nivel komunal

*Objektivi: të informohen masat dhe planet komunale për rimëkëmbje nga COVID-19 për të udhëhequr mbështetjen lokale dhe ndërkombëtare në përmbushjen e sfidave komunale për rimëkëmbje të qëndrueshme*

*Si: ushtrime të pjesëmarrjes ku përfshihen shoqëria civile, qeverisja lokale dhe bizneset, për të ndërmarrë një vlerësim të ndikimit socio-ekonomik të COVID-19 në të 38 komunat, i cili do të plotësojë vlerësimet e mëparshme prej UNDP-së, UNFPA-së, UN Women.*

31. IOM-i ka mbështetur autoritetet për menaxhim efektiv të sistemit për pritje në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke ndihmuar në plotësimin e nevojave bazë dhe duke garantuar dinjitetin e migrantëve. Kjo përfshiu krijimin e **Qendrës së Regjistrimit dhe Pritjes në Vranidoll**, me mbështetjen e Bashkimit Evropian, për të akomoduar 55 persona në lëvizje. Qendra do të strehojë dhe përmirësojë mbrojtjen e migrantëve të bllokuar, të cilët deri më tani kanë jetuar në risk të lartë shfrytëzimi dhe abuzimi në rrugë ose në banesa të mbipopulluara.
32. **94 persona u kthyen** në Kosovë nga vende të ndryshme të BE-së dhe 18 migrantë u kthyen nga Kosova në vendet e tyre të origjinës përmes Programit të IOM-it për Kthim Vullnetar të Asistuar dhe Riintegrim.
33. **1,858 migrantë** përfituan nga ndihma e IOM-it, duke përfshirë sesione informuese, përkthim, shërbime shëndetësore dhe psikologjike, aktivitete sportive, si dhe këshillim për kthimet vullnetare të asistuar dhe riintegrimin.
34. UNKT-ja ka punuar drejt **forcimit të mbrojtjes së fëmijëve në lëvizje**, të cilët e gjejnë veten në Kosovë:
- **41 fëmijë në lëvizje** përmes Kosovës drejt Evropës Perëndimore përfituan, me mbështetjen e UNICEF-it, nga **mbështetja psiko-sociale** dhe aktivitetet edukative dhe rekreative në qendrën e azilit në Lipjan, ndërsa **69 prindër** në lëvizje morën pjesë në sesionet për prindërimin dhe mbrojtjen e fëmijëve.
  - UNICEF-i rriti **kapacitetet e 189 profesionistëve** (punëtorë socialë, zyrtarë policorë, doganierë, staf i qendrës së azilit, edukatorë, mësime dhënë) që punojnë me fëmijët në lëvizje për të ofruar shërbime të integruara dhe cilësore.
35. **133 persona** (79 gra/vajza) përfunduan proceset e regjistrimit të vonuar të lindjeve me mbështetjen e UNHCR-së, duke **shmangur pashtetësinë**.

© UNMIK, 2021, S. Ankit Ahuja





## Rritja e aftësisë institucionale për të ofruar siguri dhe sigurim publik

36. Me mbështetjen e UNDP-së, **Departamenti i Kufirit dhe Hetimeve** i Kosovës përmirësoi efektivitetin e tij, duke rezultuar në një numër më të madh të armëve të vogla, municionit dhe eksplozivëve të konfiskuar.

37. 118 zyrtarë të TIK-ut (31 prej tyre gra) dhe 100 prokurorë dhe gjyqtarë (33 gra) u trajnuan për t'i **dalluar incidentet kibernetike**, për të mbledhur prova, për të mbledhur inteligjencë online, si dhe për të kryer hetime në rrjetin e errët.



## Anti-Korrupsioni

38. UNDP-ja dhe UNODC-ja mbështetën institucionet dhe iniciativat për **luftim më të mirë të korrupsionit dhe flukseve të jashtëligjshme financiare**, si dhe për të zbatuar masat **kundër korrupsionit** dhe për rikuperimin e aseteve:

- Gjykata Supreme, me mbështetjen teknike të UNDP-së, miratoi **Udhëzuesin për Politikën Ndëshkimore për veprat e korrupsionit** duke i harmonizuar politikat ndëshkimore.
- **200 pjesëmarrës**, të mbështetur nga UNDP-ja, morën njohuri për Personat e Ekspozuar Politikisht dhe Pastrimin e Parave në Monedhë Virtuale.
- Zhvillimi dhe miratimi nga gjashtë qeveritë e Ballkanit Perëndimor, me ndihmën e UNODC, i një **Udhërrëfyesi Rajonal Kundër Korrupsionit dhe Financimeve të Jashtëligjshme**, do të forcojë përgjigjet rajonale dhe pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare.
- Nëpërmjet **platformës për raportimin e korrupsionit, kallxo.com**, të mbështetur nga UNDP-ja, janë pranuar 770 raporte nga publiku, janë iniciuar 650 ndjekje nga institucionet, janë publikuar 1,149 artikuj, dhe janë transmetuar nëntë emisione televizive "Prokurori" dhe 30 emisione në web TV.





## Rezultatet kyçe Fusha prioritare 2 Përfshirja sociale

Përafrimi me OZHQ-të



Përafrimi me Programin e Qeverisë Së Kosovës



Përafrimi me Kapitujt e Integritimit në BE dhe Fushat Prioritare



## Rrjedhoja 2:

Deri në vitin 2025, të gjitha vajzat dhe djemtë, gratë dhe burrat, veçanërisht më të marginalizuarit, gëzojnë qasje të përmirësuar dhe përdorin mbrojtje sociale të barabartë, cilësore dhe të integruar, si dhe shërbime shëndetësore universale dhe arsim cilësor

## Shëndetësia




**Forcimi i institucioneve shëndetësore**

39. **Kapacitetet për testim të COVID-19 u rritën në nivel rajonal** me mbështetjen e OBSH-së përmes dhurimit të **dy makinerive PCR, dy makinerive ekstraktuese**, dhe 10,000 kompleteve të testimit për laboratorët rajonalë në Gjilan dhe Prizren. Duke dhuruar gjithsej **170,000 komplete testesh PCR** në mbarë Kosovën, UNKT-ja kontribuoi në rritjen e kapaciteteve të testimit pothuajse **30-fish krahasuar** me fillimin e krizës (nga një pikë e ulët prej 500 në fillim të vitit 2020 në mbi 14,200 teste ditore në gusht 2021).
40. **Vaksinimet kundër COVID-19 filluan më 29 mars** kur u dorëzua grupi i parë i vaksinave përmes instrumentit COVAX, dhe

Kryeministri dhe disa përfaqësues të OKB-së e morën publikisht vaksinën për të ngjallur besim. Më 15 maj, hyri në fuqi një Plan i Veprimit për Vaksinim Masiv, i zhvilluar me mbështetjen e OKB-së. Deri në fund të vitit 2021, **53.8 për qind e popullatës në moshë vaksinimi në Kosovë ishin vaksinuar** me dy doza, **rreth 21 për qind përmes vaksinave të dhuruara nga mekanizmi COVAX i lehtësuar nga OKB-ja.**

41. **Morgu i Prishtinës u rinovua** me mbështetjen e UNOPS-it, duke ofruar një mjedis të sigurt pune për stafin mjekësor përballë rritjes së rasteve me COVID-19.

## Rezultatet e vitit 2021 në luftën kundër COVID-19



Mbështetja e UNICEF-it e ofruar për Kosovën gjatë vitit 2021 në lidhje me ofrimin e vaksinës kundër COVID-19 dhe përhapjen e vaksinimit, mori mirënjohje të veçantë nga Ministri i Shëndetësisë i Kosovës në vitin 2022.



©UNICEF, 2021

42. Me mbështetjen e OBSH-së, Instituti i Shëndetësisë Publike mblodhi të dhëna për faktorët e riskut për sëmundjet jo ngjitëse dhe **forcoi kapacitetet e veta për të zhvilluar strategji për parandalimin e riskut, menaxhimin e kujdesit shëndetësor, monitorimin dhe mbikëqyrjen.**
43. Si rezultat i programit Universal Progressiv për Vizita në Shtëpi të mbështetur nga UNICEF-i, institucionet e Kosovës kanë marrë zotime të forta për **organizimin e transportit dhe financimin e vizitave në shtëpi në të gjitha komunat.**
44. Bazuar në avokimin e UNFPA-së për cilësinë e kujdesit për shëndetin riprodhues seksual, Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës ka **iniciuar një hetim për shkeljet sistematike të të drejtave të njeriut në lidhje me shëndetin e nënës, planifikimin familjar dhe kujdesin për abortin/pas abortit.**



## Rritja e qasjes dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore

45. Mbështetja teknike e UNICEF-it për zgjerimin e mbulimit të vaksinimit kundër COVID-19 kontribuoi në krijimin e **32 qendrave të vaksinimit** dhe mobilizimin e **270 ekipeve të vaksinimit** me kapacitet për të ofruar mbi 22,600 doza në ditë, duke përfshirë ekipet mobile që siguruan qasjen në vaksina për komunitetet jo-shumicë dhe personat me dëmtim të lëvizshmërisë.

Deri në fund të vitit 2021, **Kosova kishte vaksinuar me dy doza 53.8 për qind** të personave mbi 12 vjeç, rreth 21 për qind përmes vaksinave të dhuruara nga mekanizmi COVAX i lehtësuar nga OKB-ja.

Si rezultat i përpjekjeve të UNKTS-së, janë vaksinuar gjithsej **5,498 persona të margjinalizuar**.



46. Plani i Vaksinimit kundër COVID-19 për mbarë Kosovën iu është referuar **shprehimisht grupeve të cenueshme, duke përfshirë azilkerkuesit dhe refugjatët**, duke siguruar qasje të barabartë në vaksinime. Në arritjen e këtij momenti të rëndësishëm historik kontribuan mbështetja avokuese dhe teknike e IOM-it dhe UNHCR-së.
47. **Marrja e vaksinave kundër COVID-19** në mesin e atyre që janë në risk dhe hezitojnë u forca përmes Planit për Komunikim, Krijim të Kërkesës dhe Angazhim, të zhvilluar me mbështetjen e OKB-së, dhe pilotimit të mjeteve inovative për mbledhje të të dhënave për të informuar analizën e sjelljeve të përpiluar nga Qendra për Komunikim e UNICEF-it. Instituti i Shëndetësisë Publike, me mbështetjen e OBSH-së, krijoi një **njësi të specializuar për njohuritë mbi sjelljet**, e cila gjithashtu kreu një studim për të mbështetur shkallëzimin e vaksinimeve.
48. **Tri klinika familjare në komunitetet jo-shumicë** janë asistuar nga IOM-i me pajisje mjekësore. Për më tepër, një **klinikë shëndetësore** e krijuar me mbështetjen e IOM-it u ofroi **migrantëve kujdesin parësor shëndetësor** në Qendrën e Imigracionit për të Huajt.
49. **Mbi 400 migrantë** iu referuan institucioneve relevante për të **adresuar nevojat e tyre specifike të lidhura me COVID-19**, falë një linje informative shumëgjuhëshe të IOM-it.



Rreth 1 milion copë PPM të shpërndara nga IOM, UNDP, UNICEF, UNOPS dhe OBSH për autoritetet shëndetësore, të punësuarit e vijës së parë dhe ofruesit e shërbimeve, si dhe për grupet e cenueshme



IOM-i dhe UNICEF-i siguruan komplecte sanitare dhe higjienike për mbi 95% të shkollave (1020 shkolla), 1000 migrantë dhe 70 rezidentë të qendrës për azil



UNOPS-i dhe OBSH-ja siguruan më shumë se 170,000 komplecte testimi PCR për autoritetet shëndetësore

50. Programi **Universal Progressiv për Vizita në Shtëpi** trajtoi **më shumë se 15,000 fëmijë dhe rreth 2,500 gra shtatzëna** përmes një kombinimi të vizitave personale dhe telekonsultave. 7% e fëmijëve të vizituar ishin nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas. Logot e njohura të përdorura në mbi 140 qendra të kujdesit shëndetësor parësor ndihmuan në rritjen e vetëdijesimit të publikut.
51. Gjatë Javës Kosovare të Ushqyerjes me Gji, **250 gra shtatzëna dhe nëna të reja** morën pako mbështetëse prej UNICEF-it. 13 motra medicinale ofruan avokim në rrugë në komunat e targetuara. **400,000 qytetarë u arritën online** përmes një fushate në rrjete sociale në mbarë Kosovën.

## Mbështetja e Reagimit ndaj Pandemisë përmes Analizës:

- Vlerësimi i Shpejtë i Ndikimit Social-Ekonomik, UNDP, UNFPA, UN Women - raundi i tretë, maj 2021



Skano për më shumë

- Anketa të rregullta të perceptimit përmes platformës U-Raport të UNICEF-it
- Raporti i hartëzimit digjital për shkallën e braktisjes së shkollës prej vajzave nga komunitetet jo-shumicë, UN Women
- Vlerësimi me pjesëmarrje i ndikimit të COVID-19 te personat në lëvizje, UNHCR, qershor 2021
- Përditësime të rregullta të UNMIK/OHCHR mbi implikimet për të drejtat e njeriut prej krizës në Kosovë






52. Ofrimi i shërbimeve diagnostikuese mobile ose në distancë **ua kurseu pacientëve ekspozimin ndaj kontaminimit të kryqëzuar dhe siguroi qasje të vazhdueshëm në këshillat mjekësore** edhe në kushte të mbylljes: OBSH-ja krijoi një laborator mikrobiologjik të pajisur plotësisht dhe prokuroi **një aparat mobil për radiografi për spitalin e Graçanicës**, duke ofruar shërbime diagnostike për 10,000 persona në 16 fshatra.
- OBSH-ja krijoi një laborator mikrobiologjik të pajisur plotësisht dhe prokuroi **një aparat mobil për radiografi për spitalin e Graçanicës**, duke ofruar shërbime diagnostike për 10,000 persona në 16 fshatra.
  - Autoritetet shqyrtuan ndërprerjen e shërbimeve thelbësore shëndetësore me mbështetjen e OBSH-së dhe përcaktuan masa për financimin e shëndetësisë dhe ofrimin e shërbimeve për të mbështetur rimëkëmbjen e tyre graduale.
  - Klinikat mobile të krijuara me mbështetjen e UNDP-së dhe UN Women ofruan shërbime të fokusuara tek personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit në Gjakovë, Dragash dhe Malishevë.
  - 452 familje** nga komunitete të cenushme përfituan nga mbështetja e IOM-it përmes pajisjeve kritike mjekësore dhe ambulante.
53. **Fushata për vaksinim derë më derë** e mbështetur nga UNICEF-i, kontribuoi në shmangien e një krize dytësore shëndetësore, duke trajtuar **5,877 fëmijë** nga komunitetet me shkallë të ulët të vaksinimi historik.
54. UNOPS-i ndihmoi **në rritjen e cilësisë dhe zgjerimin e kapaciteteve në spitalet rajonale**, duke prezantuar pikat e forta në përdorimin e procedurave të përshpejtuara të prokurimit për të kapërcyer mungesat dhe vonesat e zinxhirit të furnizimit, duke siguruar çmime konkurruese në mënyra transparente: **Rinovimi i Klinikës së Radiologjisë në spitalin rajonal të Ferizajt**.
- Pajisjet imazherike** (12 ultratinguj, katër mamografi, gjashtë video bronkoskopë) të dorëzuara **në tetë spitale rajonale** në mbarë Kosovën, duke siguruar zbulimin e hershëm të simptomave dhe ekzaminimin e duhur, veçanërisht për femrat dhe gratë shtatzëna.
  - Përmirësimi i njësive së **kujdesit intensiv në spitalin rajonal të Vushtrrisë** e zgjeroi furnizimin e drejtpërdrejtë të me oksigjen mjekësor në 47 njësi shtrati.
55. **Katër komuna** (Prishtina, Prizreni, Mitrovica dhe Peja) vazhduan të ofrojnë **shërbime të pandërprera për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës** me ndihmën e UNFPA-së, duke udhëhequr rrugën që do ta ndjekin më shumë komuna në vitin 2022.
56. Anëtarët **e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas** në Mitrovicë përfituan nga mbështetja e targetuar me të drejtat e njeriut në qendër nga UNMIK/OHCHR për të avancuar të drejtat e tyre për shëndetësi, arsim, mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm; dhe një standard adekuat jetese në mes të pandemisë, duke përfshirë **menaxhimin e mbetjeve** në Mëhallën e Romëve.



57. Platformat kritike të dhënave të krijuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Shëndetësisë Publike në 2020, u mbajtën me mbështetjen e OBSH-së, duke përfshirë një mjet për mbledhjen e të dhënave për emergjencat e shëndetësisë publike dhe panel kontrolli për COVID-19.
58. UNICEF-i trajnoi 204 profesionistë të kujdesit shëndetësor parësor për këshillimin ushqyerjen me gji përmes një aplikacioni për telefon.



Lab Training  
© WHO, 2021, B.Seljimi

## Arsimi



### Forcimi i Institucioneve Arsimore

59. UNICEF-i dhe OBSH-ja kontribuuan që shkollat fillore dhe të mesme të jenë të sigurta për të nxënë me prani fizike, duke minimizuar kështu mbylljet e shkollave për shkak të COVID-19, duke përfshirë:
- Mbështetje për Udhëzimet e përditësuara të Ministrisë së Arsimit për Rihapjen e Sigurt.
  - Sigurimi i 1,556 kompleteve higjienike dhe mbrojtëse për 3,108 mësime dhënëse.
  - Vlerësimi i kushteve të ujit, sanitacionit dhe higjienës në 100 shkolla.
60. Afro 2,000 staf mësime dhënëse në mbarë Kosovën, duke përfshirë edhe komunitetet jo shqipfolëse, përfituan nga trajnimet e OBSH-së për shëndetin mendor, duke përmirësuar mirëqenien e tyre mendore.
61. Angazhimet komunale për zgjerimin e mundësive për të nxënëit e hershëm, pas avokimit të UNICEF-it rezultuan në krijimin e dy qendrave të reja të zhvillimit të hershëm të fëmijërisë të bazuara në komunitet, duke rritur kapacitetin rural.
62. Mbështetja e UNFPA-së çoi në integrimin e edukimit seksual gjithëpërfshirës në planprogramet e tre programeve Bachelor dhe tre programeve Master.



63. Trajnimi i targetuar dhe pajisjet e TI-së të ofruara përmes UNICEF-it dhe UN Women u lejuan fëmijëve në risk të përfitonin nga **mundësitë e të mësuarit dhe parandaluan braktisjen e shkollës** gjatë periudhave kur shkollat ishin plotësisht ose pjesërisht online:
- 948 fëmijë me aftësi të kufizuara morën tableta ose laptopë
  - 190 fëmijë morën laptopë dhe u trajnuan për shkathtësi bazë të TI-së dhe hulumtimit
64. Nëntë komuna **rritën cilësinë e tyre të arsimit për fëmijët me aftësi të kufizuara** në shkollat fillore përmes mbështetjes së UNICEF-it, e cila përfshinte vendosjen e 40 asistentëve të mësimdhënies dhe në përgjithësi rezultoi në rritjen e angazhimit të autoriteteve lokale për të siguruar financimin dhe resurset e nevojshme.
65. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, me mbështetjen e UNKT-së, **përmirësoi qasjen në mësimin e hershëm**

Pas avokimit të OKB-së dhe pilotëve të OKB-së, autoritetet lokale në mbarë Kosovën janë zotuar të punësojnë asistentë të mësimdhënies për fëmijët me aftësi të kufizuara, siç janë shtatë asistentët mësimdhënës të cilët tani janë në listën e pagave të komunës së Gjilanit.

- dhe mundësitë e zhvillimit për 405 fëmijë (50-50 vajza-djem), duke përfshirë 20% nga komuniteti serb dhe 11% nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas. duke përfshirë 20% nga komuniteti serb dhe 11% nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas.
- 66. **Platforma për hartëzim digjital** e zhvilluar nga UN Women, e cila është e qasshme për autoritetet, tregon faktorët që ndikojnë në shkallën e braktisjes së shkollës në mesin e grave dhe vajzave të reja nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas – duke u lejuar autoritetet të zhvillojnë masa adekuate reagimi.



Znj. Ardiana Kosumi  
Asistente e Mësimdhënies  
Komuna e Gjilanit

“Kur u rekrutova nga UNICEF-i vitin e kaluar si asistente mësimdhënëse për fëmijët me aftësi të kufizuara, ishte hera e parë që djali për të cilin kujdesesha kishte marrë ndonjëherë mbështetje profesionale në karrierën e tij akademike. Sot jam e punësuar nga Komuna së bashku me gjashtë asistentë të tjerë. E shohim si po ndryshojnë punët dhe shpresoj se shumë fëmijë me aftësi të kufizuara do të përfitojnë nga mbështetja e targetuar që do t’u ndihmojë të lulëzojnë.”



67. Hartimi i politikave institucionale është më i informuar përmes UNICEF-it për ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve të **Komisionit Këshillimor të qeverisë për Arsimin në Fëmijërinë e Hershme.**
68. 16 qendra me bazë në komunitet për ZHHF në tetë komuna përfituan

nga **ngritja e kapaciteteve për mësimdhënësit dhe materialet edukative** të siguruara prej UNICEF-it.

69. 49 edukatorë rritën kapacitetet e tyre për të **promovuar angazhimin e babait në ZHHF** përmes trajnimeve të UNICEF-it, duke u lejuar të sfidojnë normat gjinore.



70. U zbutën ndërprerjet e shkollave dhe u bënë me shpejtësi përpjekje për të përmirësuar kornizën për arsimin digjital përmes një sërë nismash të UNICEF-it, duke përfshirë krijimin e **200,000 llogarive për platformën e e-mësimit** shkollat.org, trajnimin e **2,000 mësimdhënësve** për përdorimin e platformës, kyçja e 13 shkollave në internet, si dhe pajisja me laptopë dhe tabletë për 305 mësimdhënës dhe 629 fëmijë dhe adoleshentë në nevojë. IOM-i gjithashtu pajisi **12 shkolla** me pajisje TI dhe projektorë.
71. Mbi 1,200 aktivitete u vunë në dispozicion në një **platformë digjitale të zhvillimit të hershëm të fëmijërisë** të mbështetur nga UNICEF-i, duke rritur ndjeshëm mjetet për zhvillimin fizik, kognitiv, gjuhësor dhe socio-emocional të fëmijëve. Nga platforma përfituan rreth **24,000 fëmijë në 1,000 institucione parashkollore**. Me mbështetjen e UNICEF-it, **147 edukatorë**

forcuan **shkathtësitë** e tyre për të **nxënëti në distancë për edukimin e hershëm.**

72. Një seri materialesh informative

U zhvilluan <b>8,458 video mësimore</b> nga MASHTI	<b>4 video tutoriale</b> për mësimdhënës dhe nxënës	U trajnuan <b>2,000 mësimdhënës</b> për TI dhe përmbytjen e edukimit online
--	---	---

digjitale të mbështetura nga UNICEF-i kontribuan në rritjen e **vetëdijesimit mbi rëndësinë e praktikave të mira të ushqyerjes** mes nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta.

73. **Plani i ri Strategjik i Arsimit** rriti përpjekjet për të ofruar arsim cilësor për të gjithë nëpërmjet një fokusi më të fortë në **digjitalizimin e arsimit parashkollor**, të cilin UNICEF-i e mbështeti drejtpërdrejt duke këshilluar institucionet se si t’i ndërthurin të nxënëti dhe mjetet digjitale.



## Mbrojtja Sociale



### Mbrojtja e fëmijëve

74. Zyra për Qeverisje të Mirë, me mbështetjen e UNICEF-it, harmonizoi 10 udhëzime të qeverisë, duke përmirësuar kornizën ligjore për të krijuar mekanizma koordinues për mbrojtjen e fëmijëve.
75. Një qendër në Prishtinë që u ofron fëmijëve në situata të cenushme shërbime të integruara psikosociale, arsimore dhe këshilluese, arriti t'i zgjeronte shërbimet e saj online dhe të ofruara jashtë objektit me mbështetjen e UNMIK/OHCHR, duke lejuar ndihmën e vazhdueshme gjatë gjithë pandemisë.
76. Aftësia institucionale e Kosovës për t'i mbrojtur fëmijët nga puna e fëmijëve është forcuar dukshëm me mbështetjen e ILO-s, duke përfshirë:
  - Përmirësimi i bazës së të dhënave të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për rastet e punës së fëmijëve, lejon përpunimin digjital, raportimin kundrejt treguesve të standardizuar dhe ndërveprueshmërinë me bazat e tjera të dhënave, si dhe Sistemet për Paralajmërim të Hershëm të institucioneve të tjera, duke forcuar bazën e dëshmimeve për përgjigje të sakta të politikave.
  - Miratimi nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve i Procedurave Standarde të Operimit për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të punës së fëmijëve.
  - Ngritja e kapaciteteve të 300 zyrtarëve dhe 381 mësimeve për të identifikuar, raportuar dhe menaxhuar rastet e punës së fëmijëve.



### Vazhdimi i shërbimeve për popullatën

77. Grupi Koordinues për Shëndetësinë i Donatorëve, i bashkëkryesuar nga Koordinatorja për Zhvillim dhe Banka Botërore, vazhdoi të luajë një rol kyç në kanalizimin e asistencës zhvillimore për Ministrinë e Shëndetësisë për të luftuar pandeminë në dobi të qytetarëve.
78. 40 Qendra për Punë Sociale dhe qendra rezidenciale janë pajisur me pajisje esenciale higjienike nga UNDP-ja, duke kontribuar në vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve në pajtueshmëri me masat shëndetësore dhe të sigurisë.

79. **3,253 familjeve** u pajisën me pako emergjente ushqimore/jo-ushqimore me mbështetjen e IOM-it, për të adresuar nevojat urgjente të sigurisë ushqimore të shkaktuara nga pandemia.

80. UNKT-ja dhe UNMIK-u së bashku promovuan vlerësimet e bazuara në të dhëna për t'i informuar masat komunale për rimëkëmbje nga COVID-19 në të 38 komunat.



### Sigurimi i informacionit të verifikuar

81. UNKT-ja ka vazhduar të punojë nga afër me UNMIK-un për përkthimin e materialeve informative publike të verifikuara për COVID-19 për të gjitha komunitetet e Kosovës.
82. Fushata shumëgjuhëshe për vetëdijësimin e publikut janë zhvilluar me institucionet e Kosovës. Rrjetet sociale, instalimet nëpër rrugë dhe njoftimet publike promovuan pajtueshmërinë me masat e kontrollit/parandalimit, duke kapur më shumë se 1.5 milion shikime.



Shtrirja e fushatave të parandalimit dhe informimit për COVID-19 të zhvilluara me mbështetjen e UNICEF dhe UNFPA, si dhe UNDCO:

**5 milionë përmes #PërHatër dhe 1.5 milionë përmes #SëBashku**



@UNFPA, 2021



@UNDCO, 2021, A. Llapashitica

## Rezultatet kyçe Fusha prioritare 3 Rritje ekonomike reziliente, e qëndrueshme, gjithëpërfshirëse

### Përafrimi me OZHQ-të



### Përafrimi me Programin e Qeverisë së Kosovës



### Përafrimi me Kapitujt e Integrimit në BE dhe Fushat Prioritare



## Rrjedhoja 3

Deri në vitin 2025, femrat dhe meshkujt në Kosovë, veçanërisht të rinjtë dhe grupet e cenueshme, gëzojnë qasje të rritur në punë të denjë dhe përfitojnë nga zhvillimi i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës ekonomik, i cili është më rezilient ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike, fatkeqësive dhe emergjencave

## Rimëkëmbja dhe mbështetja ekonomike



### Mbështetja e punësimit dhe mjeteve të jetesës

83. Një fokus i veçantë ishte në zbatimin e iniciativave për të zbutur ndikimin ekonomik të pandemisë, në përputhje me përpjekjet paralele për të mbështetur vendet e gjelbra të punës:
- 8,290 familje përfituan nga mbështetja në para të gatshme dhe në natyrë e ofruar përmes skemës së kuponëve për ushqime dhe produkte higjienike, dhe 2,100 familje përfituan nga kostot e subvencionuara të shërbimeve

nëpërmjet mbështetjes së UNDP-së, duke siguruar qasje në mallrat dhe shërbimet thelbësore përkundër rritjes së çmimeve.

- Mbi 30,000 individë nga komunitetet jo-shumicë arritën t'i rezistonin më mirë ndikimit të pandemisë, qoftë si rezultat i rritjes së të hyrave familjare apo përmirësimit të qasjes në shërbimet publike të marra prej IOM-it.

- 59 familje morën ndihmë për kthim ose riintegrim prej IOM-it në formën e ndihmës për rindërtim, trajnim, mbështetje për biznes ose arsim, ose qasje në shërbimet sociale.
- 84. Me pandeminë që tërhoqi vëmendjen ndaj nevojës për një treg pune më rezilient, UNKT-ja i ka përfunduar përpjekjet e veta për të mbështetur mundësi cilësore pune dhe për të ofruar mbështetje efektive për punësim dhe papunësi.
- ILO mbështeti hartimin e planit të parë të zbatimit të Kosovës për një Garanci të përfunduar për Rininë, e cila synon të sigurojë që të gjithë të rinjtë nën moshën 30 vjeçare të marrin një ofertë cilësore për punësim, arsimim të vazhdueshëm, praktikë ose stazh brenda një periudhe prej katër muajsh pasi largohen nga arsimi ose mbeten të papunë.
- Programi i UNDP-së për tregjet aktive të punës solli përfitime për **510 punëkërkues të regjistruar** (58% gra, 13% nga komunitetet jo-shumicë) përmes trajnimit në vendin e punës, subvencionimit të pagave dhe programit të vetëpunësimit.
- 1,036 të rinj** kanë përfituar nga **praktika me pagesë** për tre deri në gjashtë muaj dhe **mentorim** në një sërë sektorësh dhe biznesesh, duke ua mundësuar kalimin e tranzicionit nga shkolla në punë, si p.sh. përmes platformës Kosova Generation Unlimited, e mbështetur nga UNICEF-i, dhe përmes bashkëpunimit të UNDP-së me MKRS-në. Të paktën 290 prej këtyre të rinjve (28%) e mbajtën **vendin e punës**.
- Nëpërmjet programit Techstitution të mbështetur nga UNICEF-i, **541 të rinj** morën **trajtime për shkathtësitë për TIK**.
- 510 punëkërkues të regjistruar (58% e tyre gra dhe 13% nga komunitetet jo-shumicë) përfituan nga **masat e punës aktive** të mbështetura nga UNDP-ja, duke përfshirë trajnimin në vendin e punës dhe subvencionet e pagave.
- 149 ide biznesi** përfituan nga mbështetja e granteve të IOM-it, duke targetuar gratë, të rinjtë dhe grupet e marginalizuara.



©UNICEF, 2021



85. UNKT-ja vazhdoi të promovojë dhe mbështesë përpjekjet e Kosovës drejt energjisë më të besueshme, të pastër dhe përmirësimit të shëndetit dhe mirëqenies së popullsisë:
86. UN-Habitat krijoi një platformë për veprim **lokal për klimën**, duke bashkuar 28 udhëheqës lokalë dhe shoqërinë civile të Kosovës për të vendosur një agjendë të përbashkët dhe nisma të udhëhequra nga komuniteti.
- Katër intervenime të pilotuara në Prizren me mbështetjen e UNDP-së promovuan **ekonominë qarkore** dhe **rritjen e gjelbër** përmes përdorimit më të mirë të resurseve ekzistuese, duke shfrytëzuar platformat sociale.
  - U krijua një **Këshill për Ndryshimet Klimatike** me ndihmën e UNDP-së.
  - Tre **dialogë të sektorit publik-privat** mbi turizmin e qëndrueshëm dhe rritjen e gjelbër u organizuan me mbështetjen e UNDP-së, duke përcaktuar rrugën për rritje të pjesës së energjisë së ripërtërishe të bizneseve private dhe për nxitjen e modeleve të rritjes miqësore ndaj

klimes. 24 studentë universiteti, duke përfshirë 13 femra, morën trajnime dhe mentorim të gjerë për të zhvilluar **ide inovative biznesi** për ekoturizmin dhe 17 ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme (pesë prej tyre të udhëhequra nga gra) morën trajnim për shkathtësi të rimëkëmbjes së gjelbër nga pandemia.

- FAO mbështeti krijimin e një themeli më të fortë për **mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të pyjeve** në Kosovë përmes një Strategjie të re Sektoriale të Pylltarisë 2022-2030 të hartuar në mënyrë pjesëmarrëse dhe të miratuar nga Qeveria në dhjetor 2021, dhe siguroi mbështetje për udhëzimet administrative dhe rregulloret për ligjshmërinë e drurit dhe planifikimin dhe shfrytëzimin e pyjeve. **34 zyrtarë dhe 10 gazetarë** përfituan nga **trajnimi i FAO-s për prerjet e paligjshme**, rritjen e bashkëpunimit ndërmjet zyrtarëve të zbatimit të ligjit dhe raportimin transparent për çështjet me interes publik.




Solar Panels at Municipal Administrative Building in Prizren ©UNDP, 2021, T. Talosh

87. Fushata të shumta avokimi dhe veprimi për marrëdhëniet me publikun kontribuan në zhvillimin e qëndrueshëm urban, mbrojtjen e mjedisit dhe veprimin e përsheptuar për klimën në të gjitha nivelet e shoqërisë:
- Fushata globale e UNDP-së “Mos zgjidhni zhdukjen” gjeti jehonë në mbarë Kosovën me ndihmën e “Dinozaurit Frankie” në koncerte, fushata dhe instalacione publike.

**Sfida e parë për mbeturinat ushqimore** e organizuar nga UNDP-ja rriti **vetëdijesimin për humbjet dhe mbeturinat ushqimore** si ndotës kryesorë të mjedisit.

- Dita e Nënës Tokë më 22 prill, u shënua me një javë aktivitete nga anëtarë të ndryshëm të UNKT-së, duke përfshirë **ngritjen e një kopshti urban**, një event të **revolucionit të modës**, dhe **mbjelljen e fidanëve** nga komunitetet e të kthyerve në Plemetin (Obiliq).



“Ndryshimi i klimës është sfidë komplekse globale që kërcënon mbijetesën e planetit tonë – dhe bashkë me të edhe vetë ekzistencën tonë. Risqe të tilla komplekse kërkojnë një qasje sistematike dhe një vizion të përbashkët. Forumi Lokal për Veprim për Klimën (LoCAF) i mbështetur nga UN-Habitat ofron hapësirën për nxitjen e njohurive dhe udhëheqjes për ndryshimin e klimës dhe inovacionin. Ne i fuqizojmë anëtarët tanë për të ofruar veprime për zgjidhje sistematike dhe, duke e bërë këtë, për të ndërtuar një të ardhme të sigurt, të qëndrueshme dhe më reziliente.”

Znj. Indira Kartalozzi  
Themeluese e Sustainability Leadership Kosovo, Kryesuese e Komitetit Drejtues të LOCAF

## Në fokus: UNKT #KosovoClimateAction

- Fushata ombrellë filloi në shtator 2021 në partneritet me Italinë dhe MB-në (bashkë-sponsorët e COP26)

### Pikat kryesore

- Ndërtimi i një diskursi publik rreth veprimit për klimën në Kosovë duke mobilizuar industrinë e mediave, filmit dhe artit për t'i përforcuar zërat e aktivistëve
- Nxitja e veprimeve konkrete nëpërmjet angazhimeve vullnetare
- U ofrua një platformë për t'i dëgjuar zërat e të rinjve për veprimin për klimën (780 të rinj të anketuar përmes "Vetë-raportimit")
- Iniciativat përcjellëse u organizuan nga udhëheqësit për klimën të angazhuar në fushatë, duke përfshirë një festival të filmit për klimën, biseda të rregullta në lidhje me klimën në radion dhe dhe artikuj në shtypin e Kosovës.

Zbuloni më shumë në  
rrjetet sociale duke  
përdorur  
#VeprimPërKlimënKosovë



## Tregu i punës dhe punësimi



### Të drejtat dhe siguria e punëtorëve

88. UNKT-ja i ka bashkuar me sukses forcat për të forcuar menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit në punë me synimin për të promovuar punën e denjë për të gjithë:


- Një rregullore e re për Vlerësimin e Riskut në Vendin e Punës u miratua në prill me mbështetjen e UN Women, duke forcuar kornizën rregullore për masat e sigurisë dhe shëndetit, duke përfshirë edhe për gratë.
- UNOPS-i dhe UN Women mbështetën bashkërisht krijimin në kuadër të Ministrisë së Financave të një Biblioteke Digjitale për çështjet e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, duke ofruar informacion mbi legjislacionin, politikat dhe standardet, si një resurs kryesor për punëdhënësit dhe të punësuarit.
- Analizat e ILO-s dhe UN Women të sektorit dhanë të dobishme të mangësive dhe rekomandime se si të harmonizohet legjislacioni i Kosovës me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira.
- Strategjia dhe plani shumëvjeçar i trajnimit i Inspektoratit të Punës për vitet 2021–2024, i përgatitur me mbështetjen teknike të ILO-s, përmes avokimit të UN Women, ka integruar gjithashtu standardet e punës me ndjeshmëri gjinore në modulet bazë dhe të avancuara të trajnimit për sigurinë dhe shëndetin në punë.





## Rezultatet kyçe Fusha prioritare 4

# Kohezioni social



## Rrjedhoja 4:

Deri në vitin 2025, të gjitha komunitetet në Kosovë përfitojnë në mënyrë të barabartë nga angazhimi gjithëpërfshirës dhe kohezioni më i madh social.

89. UNKT-ja ka kontribuar në sigurimin e një shkalle më të lartë besimi ndërmjet grupeve etnike, si dhe ndërmjet popullatës dhe institucioneve, duke u fokusuar në angazhimin dhe fuqizimin e grupeve të përjashtuara dhe të cenueshme si agjentë të ndryshimit në avancimin e besimit dhe kohezionit social me institucionet dhe autoritetet publike. Besimi ndërmjet komuniteteve është forcuar

përmes mbrojtjes, ruajtjes dhe promovimit të **trashëgimisë kulturore**, duke çuar përfundimisht në kohezionin social. UNKT-ja bëri gjithashtu përpjekje të konsiderueshme për të katalizuar angazhimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve, me synimin për forcimin e ndërtimit të besimit dhe reziliencës ndërmjet komuniteteve dhe për uljen e ndikimit të paragjykimëve.

## Dygjuhësia

90. Për herë të parë, me mbështetjen e IOM-it Fakulteti Filologjik i Universitetit të Prishtinës përfshiu gjuhën shqipe dhe serbe si gjuhë zyrtare të rregullores së **Qendrës së Gjuhëve**,

duke shënuar një moment historik të rëndësishëm drejt promovimit të shumëgjuhësisë dhe kohezionit social në arsimin në Kosovë.

91. Përmes asistencës së IOM-it, Universiteti i Prishtinës e **riakreditoi Programin e Studimit të Ballkanistikës** për tri vitet e ardhshme, duke regjistruar 40 studentë në vitin e parë të tij.

92. 65,983 persona kanë përfituar nga qasja në përbajtje mësimore në gjuhët zyrtare të Kosovës përmes **platformës online të mësimit të gjuhës VocUp** të krijuar nga UNMIK/OHCHR në bashkëpunim me IOM-in. Prej tyre, **mbi 1,500** persona (60% gra) **morën certifikata për gjuhën shqipe dhe serbe**.



## Riintegrimi në komunitet

93. **Dy qendra komunitare lokale** për komunitetet pritëse dhe të kthyerit dhe **katër hapësira të komunitetit** u rinovuan/ndërtuan me mbështetjen e IOM-it, duke lehtësuar integrimin dhe duke nxitur shkëmbimin dhe dialogun me komunitetet pritëse.

94. UNDP-ja mbështeti riintegrimin në tregun e punës të 144 personave të riatdhesuar nga Evropa Perëndimore.



“Studimi i shqipes dhe serbishtes në nivel diplome do të na lejojë të kemi besim të plotë në angazhimin në një sërë temash komplekse në të dyja gjuhët. Ne planifikojmë ta përdorim atë që mësojmë gjatë studimeve tona për të pasur perspektiva më të mira pune dhe për t'u shërbyer komuniteteve si Kamenica, ku shqipfolësit dhe serbishtfolësit jetojnë krah për krah.



-Bojan Stamenkoviç dhe Teuta Kastrati  
Kandidatë B.A.  
Ballkanistikë,  
Universiteti i Prishtinës





95. **Qendra Burimore për Personat e Zhdukur**, me mbështetjen e përkushtuar të UNDP-së, aprovoi një strategji dhe punoi drejt depolitizimit të procesit për personat e zhdukur. Fondi për të Drejtën Humanitare vazhdoi t'i monitorojë dhe analizojë rregullisht të gjitha gjykimet lidhur me konfliktin.



©UNDCO, Sh. Qamili, 2021

96. **130 persona** (50% nga komunitetet jo-shumicë dhe 50% femra) morën pjesë në idetë bashkëpunuese të biznesit nën **iniciativën Heronjtë e Teknologjisë** të mbështetur nga IOM-i, çka u lejoi të bashkë-dizajnonin zgjidhje teknologjike për t'i përmirësuar së bashku komunitetet lokale.
97. 70 përfaqësues të mediave (60% gra dhe vajza të reja) përfituan nga iniciativat e UN Women për ngritjen e kapaciteteve, për t'u promovuar më aktivisht në iniciativat e vazhdueshme dhe për të siguruar raportim të ndjeshëm ndaj gjinisë për ndërtimin e paqes në mediat e Kosovës, si dhe integrim më të fortë të agjendës së Grave, Paqes dhe Sigurisë.

**322 të rinj** (48% ferma) rritën **vetëdijesimin** e tyre për **lajmet e rreme** ose shkathtësitë e të **menduarit kritik** përmes punëtorive të IOM-it.

98. Platforma e mediave jo-shumicë

KoSSev, me mbështetjen e IOM-it ka trajnuar platforma lokale të mediave jo-shumicë për të luftuar paragjykimet në raportim. Përmes raportimit më të balancuar, mbi **500 artikuj lajmesh** të transmetuara në mediat kryesore në Serbi dhe Kosovë kontribuan në rritjen e besimit ndërmjet komuniteteve.

99. **Konkursi** i IOM-it për **Heronjtë e Teknologjisë** i zbatuar nga Akademia jCoders mbledhi së bashku **130 pjesëmarrës nga komunitete të ndryshme** (50% gra dhe 50% nga komunitetet jo-shumicë) për të dizajnuar së bashku zgjidhje teknologjike për të mirën e shoqërisë. Krahasuar me 38% të popullatës normale, në fund të programit Heronjtë e Teknologjisë, 68% e pjesëmarrësve



100. Një event i nivelit të lartë nga UNHCR-ja për riintegrimin në komunitet, rezultoi në një raport mbi **sfidat e qëndrueshmërisë dhe riintegrimin të të kthyerve dhe personave të zhvendosur**. Raporti zbuloi se vetëm pesë komuna kishin një plan (të pabuxhetuar) për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme.
101. Rreth **240 fëmijë nga komunitetet e Mëhallës së Romëve** e ndoqën shkollën rregullisht përmes mbështetjes dhe avokimit të UNICEF-it.

102. **32 banorë nga Mëhalla e Romëve** kanë mundur të marrin dokumentet e nevojshme (regjistrimi i lindjes, letërnjoftim personal) përmes asistencës së UNICEF-it, duke rritur besimin e komunitetit ndaj institucioneve për ofrimin e shërbimeve.
103. Pesë **komuna** (Peja, Prishtinë, Mitrovica e Jugut, Gjakova, Fushë Kosova) i kanë rritur kapacitetet e tyre për të **identifikuar dhe zbutur** risqet dhe ndikimet e **martesave të hershme**, dhe për të reduktuar braktisjen e shkollës nga vajzat e reja, veçanërisht në mesin e grupeve të romëve, ashkalive dhe egjiptasve, përmes mbështetjes së UN Women.



©UNICEF, S.Karahoda, 2021





## Fuqizimi i të rinjve

104. Përmes **kampit për tregimtarinë dhe aktivitetet e bibliotekës së gjallë** të mbështetur nga UNMIK/OHCHR, rreth 200 të rinj nga komunitete të ndryshme mësuan për të drejtat e tyre të njeriut, me fokus të veçantë në të drejtat ekonomike dhe sociale gjatë pandemisë COVID-19.
105. 56,000 shikime të fushatës për edukimin për të drejtat e njeriut në rrjete sociale të mbështetur nga UNMIK/OHCHR dhe që targetoi të rinjtë.

106. Nga UNFPA-ja u zhvillua një **manual për trajnerë dhe edukatorë**, të të rinjve, i cili synon t'i pajisë udhëheqësit rinorë me mjetet dhe rekomandimet e nevojshme për të adresuar çështjet e DHBGJ-së, gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit, duke targetuar të rinjtë më të cenueshëm dhe të vështirë për t'u arritur, dhe duke u fokusuar në rolin e dialogut dhe edukimit informal.
107. Qendra Gjelbër e ndërmarrësisë e themeluar në Universitetin e Prishtinës me mbështetjen e UNDP-së, në partneritet me Venture UP, shërbeu si inkubator dhe urë lidhëse ndërmjet arsimit dhe tregut të punës në fushën e qëndrueshmërisë mjedisore.



## Mbrojtja e trashëgimisë kulturore

108. **Nëntë OJQ (pesë prej të cilave të udhëhequra nga gra)** përfituan nga aktivitetet e UNDP-së për ngritjen e kapaciteteve për promovimin e trashëgimisë kulturore jomateriale përmes ndërtimit të shkathtësive dhe ngritjes së vetëdijesimit, gjë që forcoi **kapacitetet e tyre për t'i bashkuar gratë dhe të rinjtë** nga komunitete të ndryshme, si agjentë të ndryshimit për promovimi i dialogut ndërmjet komuniteteve dhe për pranim më të madh ndërmjet komuniteteve. Gjithsej u


- angazhuan 270 pjesëmarrës (140 gra, 124 të rinj).
109. **14 studentë** mësuan të dokumentojnë, ruajnë, ringjallin dhe interpretojnë trashëgiminë kulturore në një kamp restaurimi në Sahat Kullën në Prishtinë të mbështetur nga UNDP-ja. Më shumë se 70 pjesëmarrës (90% gra, 50% komunitete jo-shumicë) përfituan nga trajnimi për trashëgiminë kulturore jomateriale për dizajnimin e punimeve artizanale, promovimin, brendimin dhe mundësitë e shitjeve.



©UNDP 2021



## Rritja e barazisë gjinore dhe e pjesëmarrjes, fuqizimit dhe angazhimit qytetar të bartësve të të drejtave



### Rrjedhoja 5:

Deri në vitin 2025, të gjitha gratë dhe burrat në Kosovë, veçanërisht të rinjtë, grupet e cënueshme dhe personat e zhvendosur, gjithnjë e më shumë e arrijnë barazinë gjinore dhe i kërkojnë të drejtat e tyre, si dhe i përbushin përgjegjësitë qytetare

110. UNKT -ja vazhdoi avokimin për prosperitet të përbashkët dhe cilësi më të mirë të jetës për të gjithë në Kosovë dhe punoi drejt përmirësimit të politikave të bazuara në dëshmi dhe me përqendrim të drejtë, si dhe për angazhimin e atyre që kanë mbetur pas, duke përfshirë përmes partneriteteve inovative. UNKT-ja bëri gjithashtu përpjekje të konsiderueshme për të katalizuar angazhimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve, me synimin për forcimin e kohezionit social dhe reziliencës ndërmjet komuniteteve dhe për uljen e ndikimit të paragjytimeve.

Shumë aktivitete të zbatuara kontribuuan në adresimin e çështjeve të ngritura të dhunës në baza gjinore, çka kulmoi me miratimin e strategjisë së parë kundër dhunës në familje në përputhje me Konventën e Stambollit.



### Kundërveprimi ndaj dhunës në baza gjinore dhe përkrahja e fuqizimit të grave dhe barazisë gjinore

111. **Strategjia e re për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave**, në përputhje me Konventën e Stambollit, e hartuar në vitin 2021 me mbështetjen teknike nga UN Women dhe kontributin e anëtarëve të tjerë të UNKT-së dhe e miratuar nga qeveria në janar 2022, pritet të avancojë përmirësimet në parandalimin, mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për gratë e mbijetuara.
112. Një analizë e situatës nga UNFPA dhe hartëzimi i shërbimeve të disponueshme dhe **programeve për autorët** e dhunës në familje, përcaktoi një udhërrëfyes pilot për shërbimet e këshillimit për dhunuesit.
113. Në nivel qendror, për të promovuar integrimin e **buxhetit të përgjegjshëm gjinor** në legjislacionin kyç, planifikimin dhe alokimin e buxhetit, UN Women mbështeti zhvillimin e një ligji të ri për Menaxhimin e Financave Publike përmes Agjencisë për Barazi Gjinore.
114. Policia e Kosovës, e mbështetur nga UN Women, lansoi një **Doracak për Shërbimet Policore të Përgjegjshme ndaj Gjinisë për Gratë dhe Vajzat që i nënshtrohen dhunës**, i cili trajtoi hendekët dhe sfidat në zbatimin e përgjigjeve ndaj rasteve të dhunës në familje.



Parimet e Kombeve të Bashkuara për Fuqizimin e Grave përfaqësojnë një përkushtim të rëndësishëm nga ana e Meridian për të promovuar barazinë gjinore nëpër shitoret dhe bizneset tona. Ne po u sinjalizojmë të punësuarave që i vlerësojmë ato, se e vlerësojmë punën e tyre dhe se nuk do të tolerojmë asnjë lloj ngacmimi seksual ndaj tyre. Jemi të bindur se investimi për gratë dhe lidhshmërinë e grave do të na bëjë një biznes më të mirë në të gjitha aspektet. Këtu fitojnë të gjithë.



Z. Agon Gashi  
Kryeshef Ekzekutiv,  
Meridian Corporation



115. UN Women ka promovuar në mënyrë aktive përkushtimin e bizneseve kosovare ndaj Agjendës 2030 dhe OZHQ 5 përmes Parimeve të Kombeve të Bashkuara për Fuqizimin e Grave. Në dhjetor, një nga korporatat më të mëdha të Kosovës për shitje me pakicë bëri **një njoftim prej nivelit të lartë udhëheqës në mbështetje të Parimeve të Fuqizimit të Grave**, duke iu bashkuar një komuniteti prej 5,000 biznesesh në mbarë botën.
116. UNDP-ja promovoi pjesëmarrjen e OJQ-ve të grave në zbatimin e aktiviteteve që lidhen me riciklimin dhe ekoturizmin nën ombrellën e intervenimeve në pellgun e Lumit Drin të financuara nga Fondi Global i Mjedisit, ku gratë përfaqësojnë 30% të anëtarëve të Grupit Bërthamë të Drinit dhe afërsisht 60% të anëtarëve të Grupeve Punuese të Ekspertëve të Grupit Bërthamë të Drinit.
117. UNDP-ja siguroi mbështetje financiare për **17 gra në biznes**

- (gra të mbijetuara nga DhF/DhBGj, nga komunitetet rome, ashkali, egjiptase, gra rurale dhe gra me aftësi të kufizuara) për të zhvilluar shkathësi të reja ose mundësi pune, për të gjeneruar të hyra dhe për t'i diversifikuar bizneset ekzistuese.
118. Për të kundërvepruar ndaj ndikimit joproporcional që pati COVID-19 në bizneset e udhëhequra nga gratë, UN Women mbështeti **25 gra** nga grupe të cenueshme përmes **trajtimeve për ndërmarrësi** dhe mbështetjes me grante për të hapur bizneset e tyre.
119. Përmes aktiviteteve të targetuara, UNMIK/OHCHR lehtësoi riintegrimin social dhe ekonomik dhe rehabilitimin e të mbijetuarve të DhSLK-së përmes ofritit të informacionit, mbështetjes me ndihmë juridike dhe programimit të fuqizimit ekonomik.



UNFPA, 2021  
V. Buçolli/A. Palaziti

Arbër Matoshi— me rastin e festivalit të UNFPA-së për Ditën e Baballarëve, ku u paraqit roli i baballarëve në prindërimin bashkëkohor

Unë jam baba i përkushtuar që besoj fort në prindërimin e barabartë dhe të përbashkët. Baballarët si unë në Kosovë e ndjejnë gjithmonë se jemi pakicë dhe se mbizotëron mënyra tradicionale, por ky festival e kremtoi mënyrën tonë të prindërimit dhe unë u ndjeva krenar dhe i inkurajuar



## Të dhëna për të drejta të përmirësuara

120. Për herë të parë, Agjencia e Statistikave të Kosovës filloi **mbledhjen dhe konsolidimin e të dhënave të serive kohore** nga të dhënat jetike të regjistrimit për lindjet dhe vdekjet, me mbështetjen e UNFPA dhe UNICEF, në përputhje me rekomandimet e Grupit të Agjencive të OKB-së për Vlerësimin e Vdekshmërisë së Fëmijëve. Ky përfaqëson një hap të rëndësishëm përpara në avancimin e **politikëbërjes së bazuar në dëshmi**.
121. Me mbështetjen e UNKT-së, Ministria e Shëndetësisë i unifikoi dhe **digjitalizoi të dhënat e imunitetit** në kuadër të Sistemit të Informacionit Shëndetësor të zhvilluar rishtazi.
122. UNICEF-i mbështeti Zyrën për Qeverisje të Mirë dhe Agjencinë e Statistikave të Kosovës për të iniciuar një ushtrim të hartëzimit të të dhënave të lidhura me fëmijët, për të informuar zhvillimin e një baze të dhënash në **Kosovë për monitorimin dhe raportimin për të drejtat e fëmijëve**.



“Çdo grua që vërtet dëshiron të punojë, me pajisjet e duhura mund të arrijë gjithçka. Falë pajisjeve prej OKB-së, tani jemi në gjendje të prodhojmë më shumë grurë dhe ushqim për bagëtinë, pa huazuar pajisje prej komshinjve tanë.”

Fakete dhe Luljeta Rexhepi,  
Farmere nga Rashkoci  
(Gjakovë)



## Angazhimi Qytetar

123. **Vlerësimi i Gatishmërisë Digjitale** prej UNDP-së krijoi një platformë për dialog me palët kyçe të interesit nga institucionet, sektori privat, academia dhe shoqëria civile, me synimin për të përsheptuar tranzicionin drejt ekonomisë digjitale,

përfshirjes digjitale dhe transformimit të drejtuar nga të dhënat. Platforma eksploroji prioritetet për rrugën përpara, duke përfshirë rritjen e shërbimeve elektronike, ndërtimin e besimit publik ndaj platformave online, përfshirjen e grave në bizneset digjitale, si dhe rritjen e zhvillimit të shkathtësive digjitale

124. Duke prezantuar aftësinë e tyre të përfunduar për të monitoruar dhe raportuar mbi çështjet kyçe të të drejtave të njeriut falë mbështetjes për ngritjen e kapaciteteve nga UNMIK/OHCHR, 34 organizata joqeveritare për të drejtat e njeriut hartuan bashkërisht raportin e dytë të përbashkët vjetor mbi situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë, duke ofruar rekomandime konkrete për institucionet e Kosovës.
125. Mijëra të rinj u pajisën me njohuri dhe shkathtësi avokuese për të adresuar nevojat dhe të drejtat e tyre, si dhe ato të komuniteteve të tyre.

**6,785 adoleshentë dhe të rinj** u arritën dhe u lidhën përmes programeve të ndryshme të UNICEF-it të fokusuar në zhvillimin e shkathtësive.

- a. **1,027** adoleshentë dhe të rinj përfunduan një program të zhvillimit të shkathtësive për **zgjidhjen e problemeve dhe të menduarit kritik**.
- b. **600 nxënës të nivelit të mesëm** morën pjesë në programet e zhvillimit të shkathtësive, duke përfshirë edhe formatet digjitale.
- c. **169 mësime të nivelit të mesëm** kanë forcuar kapacitetet e tyre për të mbështetur shkathtësitë jetësore dhe të punës të adoleshentëve në shkolla.



©UNICEF, 2021, Leonora Aliu

## 2.2. Mbështetja e partneriteteve dhe financimi për Agjendën 2030

126. UNKT-ja i mbajti dhe zgjeroi partneritetet e saj në vitin 2021 për të rritur sinergjitë për tejkalimin e ndikimeve shumështrësore të pandemisë dhe avancimin e zbatimit të Agjendës 2030. Resurset u mobilizuan përmes sistemit të OKB-së, institucioneve financiare ndërkombëtare, donatorëve dy dhe shumëpalësh, si dhe përmes ndarjes së kostove me institucionet e Kosovës.

127. Partneritetet e suksesshme të nisura në vitin 2020 për të siguruar rimëkëmbje të hershme vazhduan edhe në vitin 2021, siç është projekti i përbashkët për COVID-19 në sektorin e shëndetësisë dhe arsimit i financuar nga Mbretëria e Bashkuar dhe i kanalizuar përmes Fondit të Kombeve të Bashkuara për Reagimin dhe Rimëkëmbjen nga COVID-19.

128. Si partner aktiv i **Zyrës për Planifikim Strategjik të Kryeministrit**, UNKT-ja i mbështeti përpjekjet e qeverisë drejt Agjendës 2030, duke këshilluar për përafrimin e SKZH 2030 me OZHQ-të dhe treguesit e rritjes ekonomike, sundimit të ligjit dhe qeverisjes, kapitalit njerëzor dhe barazisë, dhe mjedisit të qëndrueshëm.

129. UNKT-ja kreu analiza për të identifikuar dhe çliruar resurset e nevojshme për rezultatet e Kornizës për Bashkëpunim dhe për të përshpejtuar investimet në përputhje me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Strategjia rezultuese e **UNKT-së** për

### Mobilizim të Resurseve dhe Partneritet

do të shërbejë për avancimin e agjendës për financim të OZHQ-ve në Kosovë.

130. Mbështetja e UN Women ndihmoi në avancimin e **praktikave të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor** përmes vlerësimeve më rigorozë dhe kornizave analitike për të zbrëthyer ndikimin specifik gjinor. U prezantua një Vlerësim i Ndikimit Gjinor dhe UN Women punoi nga afër me ministritë dhe institucionet qeveritare për të siguruar integrimin sistematik të praktikave të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në të gjitha nivelet. Si rezultat, Paketa e qeverisë për Rimëkëmbje Ekonomike e shpallur në qershor 2021 përfshinte **tre masa të veçanta** për të ndihmuar **rimëkëmbjen ekonomike të grave**, duke mbështetur nënat vetë-ushqyese, gratë shtatzëna dhe të papuna.

131. Angazhimi i sektorit privat ishte në qendër të përpjekjeve të OKB-së në vitin 2021. Disa partneritete u vazhduan dhe u zgjeruan. **UNICEF-i dhe Microsoft-i** vazhduan partneritetin e tyre global për **“Platformën e të Nxënësve”**, për t'u ndihmuar fëmijëve dhe të rinjëve të kenë qasje në përmbajtje cilësore mësimore në shtëpi. Me një grup të dytë të **K-Gen U**, UNICEF-i zgjeroi partneritetin e vet duke punuar me 146 subjekte publike dhe private që mbështesin fuqizimin e të rinjëve.



132. Partneritetet ekzistuese me **Odën Ekonomike të Kosovës** ndihmuan në përfshirjen e sektorit privat në reagimin ndaj COVID-19. **Platforma online** Realiteti i Ri, e krijuar në vitin 2020 në bashkëpunim me UNKT-së, Odën Ekonomike, CiviKos-it dhe OSHC-ve të tjera për të rritur vetëdijesimin për masat parandaluese, e vazhdoi punën edhe në vitin 2021. Platforma u krijua si një forum për angazhimin e ardhshëm të palëve të interesit në një sërë temash që lidhen me zbatimin e OZHQ-ve.

#### REALITETI I RI



Skano për më shumë

133. Në partneritet me **Rrjetin për Përgjegjësi Sociale të Korporatës (PSK)**, UNKT-ja inicioi diskutime me komunitetin e biznesit të Kosovës mbi rëndësinë e avancimit të qëllimeve shoqërore dhe përafrimin e strategjive dhe operacioneve të biznesit me parimet universale për të drejtat e njeriut, punën, mjedisin dhe kundër korrupsionit. Përpjekjet u përqendruan në mënyrën si mundet sektori privat t'i funksionalizojë dhjetë parimet e promovuara nga "Kompakti Global i OKB-së", iniciativa më e madhe në botë për qëndrueshmërinë e korporatave. Disa kompani treguan entuziazëm në zbatimin e Kompaktit Global. Për inovacionin dhe vizionin që shfaqën në këtë fushë, ProCredit Bank Kosova mori çmimin për PSK për vitin 2021, duke ua hapur rrugën partnerëve të tjerë në sektorin financiar.

Rrjedhimisht, UNKT-ja do të vazhdojë partneritetin e saj gjithnjë e më të zgjeruar me **Shoqatën e Bankave të Kosovës** dhe shoqatat e tjera të komunitetit të biznesit.

134. Iniciativat që fokusohen në lidhjen ndërmjet teknologjisë, të dhënave dhe qëndrueshmërisë lejuan që të shfrytëzohet fuqia e angazhimit të sektorit privat në zgjidhje të drejtuara nga të dhënat. UNKT-ja i shtoi përpjekjet në fushat e **sistemeve të qëndrueshme ushqimore** dhe për **menaxhim të mbetjeve**. Duke i sfiduar bizneset për ta shqyrtuar status quo-në

**Sfidat e mençura rreth mbeturinave të mundësuar nga UN-Habitat, i inkurajuan ndërmarrësit kosovarë që "mbeturinat t'i shndërrojnë në para të gatshme"**

#### Çka është:

- Nisma e UN Habitat në partneritet me Ambasadën e SHBA në Prishtinë dhe partnerët e Kosovës, për të përzgjedhur idetë dhe zgjidhjet e biznesit për reduktimin e mbeturinave të ngurta në qytetet dhe komunitetet e Kosovës dhe për ripërdorimin apo riciklimin e tyre.
- Sfida inkurajon bizneset të rimendojnë ciklin jetësor të produkteve dhe ndikimin në mjedis, shëndetin dhe klimën tonë, duke kombinuar teknologjinë dhe modelet inovative të biznesit për t'i "shndërruar mbeturinat në para të gatshme"

#### Pikat kryesore:

- 4 nga 56 idetë e biznesit të paraqitura për Sfidë u shpërblyen deri në 10,000 euro para të gatshme, shërbime inkubacioni dhe trajnime biznesi
- Idetë e suksesshme përfshinin riciklimin e mbetjeve biologjike në kompost dhe krijimin e filtrave të pishinave nga qelqi

dhe për t'i konsideruar alternativat, akterët e Kosovës në sektorët e gastronomisë, bujqësisë dhe prodhimit u sfiduan të mendonin për mënyra më të qëndrueshme të të bërit biznes.

135. UNKT-ja gjithashtu mbeti e përfshirë në mënyrë aktive në avancimin e **agjendës së Grave, Paqes dhe Sigurisë**. Lobi Rajonal i Grave për Evropën Juglindore, i mbështetur nga UN Women, vazhdoi të ishte një akter vendimtar në forcimin e fuqizimit të grave si shtytës kryesor për paqe. Përmes pesë aktiviteteve ndërkombëtare dhe rajonale të vitit 2021, përpjekjet e përbashkëta

i përforcuan me sukses përvojat e përbashkëta në mjediset pas konfliktit, duke rritur vizibilitetin për nevojën për udhëheqje të përmirësuar të grave.

136. **Rrjeti i Kombeve të Bashkuara për Migracionin në Kosovë** i krijuar në dhjetor 2020 vazhdoi të mbështesë bashkëpunimin, si dhe integrimin e migracionit në strategji, politika dhe korniza të tjera, dhe të promovojë diskursin e bazuar në fakte dhe të bazuar në të dhëna. Një plan pune i zhvilluar në vitin 2021 thekson rëndësinë e ndërtimit të partneriteteve. Forumi i parë i Partneritetit të Migracionit u zhvillua në nëntor 2021.

*Një hulumtim për problemin e mbeturinave ushqimore në Kosovë ka treguar se 2 deri në 20% e ushqimit të shërbyer lihet në pjatë në varësi të stilit të shërbimit të restorantit.*

**Në fokus:** UNDP i sfidon restorantet e Kosovës që të reduktojnë modelet e tyre të mbeturinave ushqimore

#### Çka është:

- Sfida e parë e UNDP-së për mbeturinat ushqimore në Kosovë u lansua me një objektiv primar: adresimi i mungesës së të dhënave në lidhje me humbjet dhe mbeturinat ushqimore në mesin e bizneseve të restoranteve në Kosovë.

#### Pikat kryesore:

- Sfida mobilizoi 18 biznese gastronomike për t'iu bashkuar një udhëtimi 3-javor të menaxhimit të mbeturinave ushqimore, ku 7 prej tyre e përfunduan me sukses. Përveç mbledhjes së të dhënave direkte, disa restorante dhe kafene filluan të identifikojnë modelet e pavërejtura më parë në menaxhimin e tyre të ushqimit dhe madje filluan të dizajnojnë zgjidhje të reja për të reduktuar mbeturinat e tyre ushqimore dhe përfundimisht për të reduktuar humbjet financiare të gjeneruara nga pandemia.





137. UNKT-ja u angazhua në iniciativa të shumta me **mediat dhe industrinë e filmit** të Kosovës për të trajtuar çështjet gjinore dhe sociale. Bashkëpunimet tona përfshinin **Festivalin e Filmit në Prishtinë**, ku kontribuam për të theksuar rëndësinë e perspektivave të grave në industrinë e filmit si një kanal kyç për të mbështetur dialogun dhe përfshirjen sociale në mjediset pas konfliktit. Nëpërmjet mbështetjes së UNKT-së, Festivali ndihmoi në amplifikimin e tregimeve të grave të Kosovës në nivel global, duke përfshirë filmin “Zgjoi”, fitues i trefishtë i Festivalit Sundance dhe kandidat zyrtar i Kosovës në kategorinë e metrazhit të gjatë të Çmimeve Oscar. UNKT-ja gjithashtu vazhdoi të mbështesë edicionin e 20-të të **DokuFest**, festivali më i madh i filmit në Kosovë dhe festivali më i rëndësishëm i filmit dokumentar

Pulsi Publik i UNDP-së është një anketë gjashtëmuajore për perceptimet në mbarë Kosovën e financuar nga USAID-i, e cila ofron të dhëna të vlefshme për vendimmarrje të informuar mbi çështjet politike dhe socio-ekonomike, demokratizimin, kënaqshmërinë me institucionet, sundimin e ligjit, funksionimin e shërbimeve publike, marrëdhëniet ndëretnike dhe tolerancën sociale, çështjet e sigurisë dhe mjedisit.

dhe të shkurtër në Evropën Juglindore. Paralelisht, UNKT-ja mbështeti edicionin e 3-të të Autostrada Bienale, duke shfaqur tema në kryqëzimin e dizajnit, teknologjisë dhe hapësirës publike. **DokuFest** dhe **Autostrada Biennale** janë platforma për promovimin e Agjendës 2030 dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

138. U forcuan më tej partneritetet ekzistuese institucionale. UNDP-ja dhe **Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)** nënshkruan një Memorandum të dytë të Mirëkuptimit për të përmirësuar më tej qasjen dhe përdorimin e të dhënave nga publiku si pjesë e projektit të Pulsit Publik të UNDP-së. Rezultatet kyçe të Pulsit Publik do të shfaqen në ueb faqen e ASK-së përmes vizualizimit online.
139. Katër vjet pas reformave zhvillimore të OKB-së, UNKT-ja, e udhëhequr nga Koordinatorja për Zhvillim dhe e mbështetur nga Zyra e përforuar e Koordinatorës për Zhvillim, i ka forcuar ndjeshëm përpjekjet e koordinimit të OKB-së për të ndërtuar partneritete më të ngushta dhe për të dhënë rezultate me ndikim në shkallë të gjerë.



## OKB-ja bashkon forcat me sektorin privat për të luftuar dhunën në baza gjinore

Fushata 16 Ditët e Aktivizmit, e koordinuar nga UN Women përmes Grupit për Sigurinë dhe Gjininë, organizoi mbi 130 evente në mbarë Kosovën. Për herë të parë, sektori privat u angazhua në mënyrë aktive, duke përfshirë 20 kompanitë më të mëdha të Kosovës, duke e zgjeruar ndjeshëm shtrirjen e fushatës.

Rreth një milion persona i shikuan postimet në rrjete sociale ose posterat e shfaqur në supermarkete që ofronin informacion mbi linjat telefonike, si dhe ku mund të kërkohet ndihmë.

U organizuan evente vetëdijesimi me të mbijetuarit, komunitat, përfaqësuesit e shtëpive të sigurta dhe policinë e Kosovës, duke rritur njohuritë për mekanizmat mbrojtës dhe proceset e raportimit.



## 2.3. Rezultatet nga puna më e madhe dhe e kryer më mirë së bashku nga OKB-ja: koherenca, efektshmëria dhe eficientia e OKB-së

140. Bashkëpunimi i OKB-së çoi në Kornizën për Bashkëpunim të UNKT-së 2021–2025, e cila përfaqëson punën kolektive për pesë vitet e ardhshme të njësive të UNKT-së dhe që integron Planin e UNKT-së për Përgjigjen Sociale-Ekonomike ndaj (SERP), të hartuar për herë të parë në vitin 2020.

141. Njëpërmjet bazës së të dhënave të UN-INFO të qasshme nga publiku, UNKT-ja ka raportuar në mënyrë transparente për kontributin në treguesit globalë të SERP në fusha si shëndetësia, mbrojtja, përgjigja ekonomike dhe kohezioni social. **UN-INFO** (lansuar në nëntor 2021) së bashku me ueb faqen e rinovuar të UNKT-së (lansuar në dhjetor 2020) luajtën një rol thelbësor në portretizimin më koherent të aktiviteteve dhe kontribuuan për planifikim, monitorim dhe raportim më të saktë. UN-INFO do të shërbejë si referencë parësore për progresin, rezultatet dhe arritjet e UNKT-së.

100 raporte për COVID-19 që nga fillimi i pandemisë 11 edicione të buletinit UNKT in Brief

142. UNKT-ja prodhoi 11 botime të buletinit të vet mujor “UNKT-ja shkurtimisht” si dhe Raporte javore për Situatën që gjurmonte tendencat, zhvillimet dhe përpjekjet kryesore të UNKT-së në luftën kundër pandemisë COVID-19.



143. **Kanalet e rrjeteve sociale** u përdorën gjerësisht për të promovuar mesazhe për popullsi të ndryshme mbi arritjet e UNKT-së dhe mesazhe rreth COVID-19, duke rezultuar në një rritje të përafërt prej 10 për qind të ndjekësve në Twitter, mbi 84 për qind rritje në shtrirjen organike të Facebook, si dhe rritje të konsiderueshme në Instagram me mbi 33 postime që kanë arritur më shumë se 200 përshtypje secili.

Koordinatorja për Zhvillim dhe Krerët e Agjencive u angazhuan në paraqitje dhe intervista të shumta në media nëpër kanalet dhe programet mediale të Kosovës, duke përfshirë 3 intervista në prime-time në kanale TV. 144. Në shkurt 2021, u miratua Strategjia e re e UNKT-së për **Operacionet e Punës 2.0**, një instrument kritik për operacione më efikase dhe të përbashkëta të punës në mbështetje të programeve më efektive.

### Programimi i përbashkët

145. Programimi i përbashkët e forcoi më tej koherencën, koordinimin dhe bashkëpunimin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, të udhëhequr nga Korniza për Bashkëpunim dhe Bashkëpunim dhe dhe rrjedhojat e saj. Dy projekte të reja filluan zbatimin në vitin 2021, duke mobilizuar 4.3 milionë dollarë amerikanë të financuar nga

Suedia dhe Luksemburgu – një shenjë e rëndësishme e përpjekjeve të suksesshme për mobilizim të resurseve në mbështetje të rrjedhëve të Kornizës për Bashkëpunim dhe përgjigje ndaj COVID-19. Totali i katër projekteve të përbashkëta arriti në 11.4 milionë dollarë amerikanë.

### Projektet e përbashkëta të UNKT-së të zbatuara në vitin 2021

Projekti	Kthimi në Normalitetin (e ri)	Përgjigja ndaj emergjencës COVID-19 dhe mbështetje për rimëkëmbje të hershme	Promovimi i punës së denjë përmes forcimit të sigurisë dhe dialogut në punë	Kosova më e shëndetshme 2
Financuar nga:	UK përmes MPTF (\$2.5m)	SIDA (\$4.6m)	SIDA (\$2.6m)	Luksemburg (\$1.7m)
Koha:	2020-2021	2020-2024	2021	2021-2023





146. Një projekt i përbashkët ndërmjet UNDP-së, OBSH-së dhe UNV-së (Kosova më e shëndetshme II), me vlerë përafërsisht 1.7 milionë dollarë amerikanë dhe i financuar nga Luksemburgu, u nënshkrua në vitin 2021 për zbatim gjatë dy viteve në vijim, me qëllim të sigurimit të qeverisjes më efektive në fushat e mjedisit dhe shëndetësisë përmes planifikimit gjithëpërfshirës dhe zbatimit të bazuar në fakte, si dhe monitorimit të ndikimeve në shëndet prej ndotjes së ajrit.

147. Koordinatorja për Zhvillim luajti gjithashtu një rol kyç në koordinimin e përpjekjeve me mbarë familjen e Kombeve të Bashkuara në rajon për të avancuar mundësitë për nisma të përbashkëta për dialogun, ndërtimin e besimit, kohezionin social dhe shoqëritë gjithëpërfshirëse, në konsultim

të ngushtë me qeveritë dhe palët e tjera të interesit në të gjithë rajonin dhe në bashkëpunim me Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Mbështetjen e Ndërtimit të Paqes.

148. Bashkëpunimi me rrjetin e OKB-së në rajonin e Ballkanit Perëndimor u forca me tej gjatë vitit 2021. U zhvilluan shkëmbime të shpeshta për të koordinuar përpjekjet e përbashkëta për rimëkëmbje nga pandemia dhe për avancim të mundësive rajonale për iniciativa dhe dialogë të përbashkët me partnerët zhvillimorë. Kjo përfshiu përpjekje të përbashkëta për të ndarë të dhënat dhe njohuritë relevante mbi fushat me interes të përbashkët në nën-rajon, veçanërisht për risqet e reja gjeo-politike dhe ekonomike globale.

151. **E tëra është më e madhe se shumta e pjesëve të saj:** Duke treguar rëndësinë e kombinimit të avantazheve krahasuese të agjencive relevante të UNKT-së, në shtator 2021, Ministria e Punëve të Brendshme, me mbështetjen e përbashkët nga UNICEF, UNHCR dhe IOM, zhvilloi dhe mbështeti

udhëzimet për **Vlerësimin e Interesit më të Mirë** dhe **Përcaktimin e Interesit më të Mirë** për refugjatët, migrantët dhe fëmijët azilkërkues për të ndihmuar që **të drejtat e fëmijëve në lëvizje të mbrohen** në përputhje me konventat e OKB-së dhe standardet ndërkombëtare.



## Fushat strategjike të bashkëpunimit të përbashkët të OKB-së

Poentimi SWAP është një komizë për llogaridhënie e OKB-së që promovon përmirësimin e planifikimit, koordinimit, programimit dhe rezultateve të Kombeve të Bashkuara për barazinë gjinore dhe vajzat në mbarë botën, me synimin për të mbështetur arritjen e angazhimeve për barazi gjinore të OZHQ-ve.

149. Gjatë gjithë vitit 2021, barazia gjinore ka mbetur vazhdimisht një prioritet kryesor për aktivitetet programore dhe strategjike të OKB-së. Për të dytin vit radhazi, UNKT-ja plotësoi ose tejkaloi 14 nga 15 treguesit e performancës

të Planit të Veprimit të Gjithë Sistemit të Kombeve të Bashkuara për **Poentimin e Vlerësimit të Barazisë Gjinore**. 150. UNKT-ja gjithashtu ka bërë përparim në zbatimin e **Strategjisë së OKB-së për Përfshirjen e Aftësisë së Kufizuar**. Vullnetarët e OKB-së filluan të ndërtojnë një linjë për kualifikim të profesionistëve me aftësi të kufizuara dhe vendosën një Vullnetar të parë të OKB-së me UNICEF-in për të punuar për një projekt për fuqizimin e të rinjve dhe për të shërbyer si shembull për të tjerët. Më shumë profesionistë të kualifikuar me aftësi të kufizuara do të rekrutohen nga agjencitë e UNKT-së përmes programit për Vullnetarë të OKB-së në të ardhmen.



Pas aksidentit, as që e mendoja se do të mund të merrem me aktivitete dhe punë. Ishte periudhë shumë e vështirë, por UNICEF-i dhe njerëzit që punojnë aty – tani kolegët e mi – më kanë ndihmuar shumë. Kam mësuar shumë dhe i thashë vetes “OK Meriton, paska zgjidhje për ty

Z. Meriton Binakaj  
Vullnetari OKB-së, UNICEF Kosovo



## Transformimi i Sistemeve Ushqimore të Kosovës

Dialogu për sistemin ushqimor të Kosovës tregoi mënyra si mund të dëgjohen zërat e Kosovës për çështje globale me rëndësi. Pjesëmarrësit diskutuan se si mund ta transformojmë mënyrën si prodhojmë, konsumojmë dhe mendojmë për ushqimin.

Më 13 korrik 2021, një event me prani fizike në Prishtinë mbledhi së bashku më shumë se 50 palë të interesit për prodhimin dhe konsumin e ushqimeve dhe deponimin e mbetjeve, për të ndërtuar një rrugë dhe zgjidhje të përbashkëta drejt përdorimit më të mirë të resurseve të disponueshme. I organizuar në partneritet me INDEP-in dhe Ministrinë e Bujqësisë, me mbështetjen e UNKT-së, eventi u dëshmuua si instrument i vlefshëm për zhvillimin e bashkëbisedimit dhe për të siguruar që zërat e Kosovës të përfshiheshin si pjesë e Samitit të parë të OKB-së për Sistemet e Qëndrueshme të Ushqimit në shtator 2021.

Pikat kryesore: Nga INDEP u përgatit një raport përcjellës, duke ofruar rekomandime të zbatueshme për politikëbërësit për çështjet e prodhimit dhe konsumit të qëndrueshëm të ushqimit dhe ekonomisë qarkore.

Eventet e organizuara më pas nga disa prej pjesëmarrësve fillestarë, vazhduan promovimin e veprimit nga të gjithë akterët e shoqërisë dhe rritjen e vetëdijesimit mbi rëndësinë e trajtimit të mbetjeve ushqimore.

**Për futjen e ndryshimeve në sistemet komplekse, së pari duhet të kemi mbështetjen e konsumatorëve, prodhuesve dhe vendimmarrësve, duke ndryshuar mendjet dhe zemrat e tyre. Diskutimi i parë i Kosovës mbi sistemet ushqimore lejoi krijimin e hapësirës shumë të nevojshme: Hapësirë për krejt sektorët për të diskutuar se si të krijohet një zinxhir i qëndrueshëm dhe i drejtë për vlerat ushqimore, në mënyrë që fermerët, tregu, qeveria dhe sistemet natyrore të funksionojnë në simbiozë.”**


*Egzona Shala, aktiviste mjedisore*

## 2.4 Pasqyra financiare dhe mobilizimi i resurseve

152. Përpara vitit 2020, zarfi për zbatimin e përbashkët të UNKT-së arrinte në rreth 20-25 milionë dollarë amerikanë në vit. Megjithatë, me fillimin e pandemisë, kjo shifër u rrit ndjeshëm dhe trendi vazhdon gjatë periudhës së zbatimit të Kornizës aktuale për Bashkëpunim, duke reflektuar efektet e zgjatura të pandemisë dhe ndikimin shoqëruës. Në vitin 2020, UNKT-ja arriti të mobilizojë shumën e paprecedentë prej 54 milionë dollarësh amerikanë, duke demonstruar aftësinë e saj për t'u bashkuar në mënyrë të unifikuar, në kohë dhe efektive.



# \$175.4 milionë

Korniza për Bashkëpunim, Resurset e kërkuara financiare gjatë viteve 2021-2025



153. Në vitin 2021, UNKT-ja shpenzoi rreth 37 milionë dollarë amerikanë për ofrimin e programit në pesë fushat e rrjedhëve të Kornizës për Bashkëpunim, duke përfshirë aktivitetet e fokusuara në përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga pandemia COVID-19. Pjesa më e madhe e shpenzimeve ranë nën Fushën Prioritare 2, veçanërisht komponentët e shëndetësisë dhe arsimit (69 për qind), pasuar nga Fusha Prioritare 3 për rimëkëmbjen ekonomike dhe rritjen e gjelbër (19 për qind), dhe Fushat Prioritare 1, 4 dhe 5 (12 për qind) për qeverisjen llogaridhënëse, kohezionin social dhe çështjet ndërsektoriale, përkatësisht. Përpjekjet e bëra në të pesë fushat prioritare kontribuan ndjeshëm në barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut.

154. Totali i përllogaritur kumulativ i resurseve financiare të kërkuara nga të gjithë anëtarët e UNKT-së për të arritur rrjedhët e Kornizës për Bashkëpunim për periudhën 2021-2025, arrin në 175 milionë dollarë amerikanë, pra një mesatare vjetore prej 35 milionë dollarësh amerikanë. Rreth 36 për qind e zarfit total (rreth 63 milionë dollarë amerikanë) ishte siguruar tashmë deri në janar 2021.



155. Resurset e disponueshme përbëhen kryesisht nga resurset bazë, si dhe nga fondet e projektit. Ky zbrëthim tregon se ka vend për diversifikimin e resurseve.

156. Përveç përgjigjes ndaj nevojave imediate të pandemisë, resurset e përgjithshme të disponueshme në vitin 2021 gjithashtu ndihmuan për avancimin e agjendës së OZHQ-ve në Kosovë, me shumicën e kontributeve që mbështetën OZHQ-të 1, 3, 5, 8 dhe 10.

157. Në vitin 2021, Qeverisë së Kosovës iu ofrua mbështetje e konsiderueshme për përgjigjen e saj ndaj pandemisë nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare (IFN), me Bankën Botërore që miratoi një financim shtesë prej 15 milionë dollarësh amerikanë për përpjekjet e vazhdueshme të rimëkëmbjes përmes një kredie ekzistuese për sektorin shëndetësor të Kosovës (gjithsej 61 milionë dollarë amerikanë).

IFN	Titulli i Projektit	Viti	Gjithsej financimi I aprovuar (EUR m)	Gjithsej financimi I disponueshëm
Banka Botërore	Projekti për Emergjencën COVID-19	2020	15	61
BEI	Përgjigja e Kosovës ndaj pandemisë COVID-19 për NVM-të	2021	40	40
Banka e Këshillit të Evropës	Financimi I Sektorit Publik për Reagimin Emergjent ndaj COVID-19	2020	15	50
BERZH	Projekti për Trajtimin e Ujërave të Zeza	2021	11	11
BERZH	Kredi për Likuiditet Emergjent për Infrastrukturën Jetike	2021	3-	30



## Kapitulli 3:

### Fokusi kyç i UNKT-së për vitin e ardhshëm





158. Të udhëhequr nga vizioni i Sekretarit të Përgjithshëm i përshkruar në raportin e **Agjendës sonë të Përbashkët** të shtatorit 2021, në vitin 2022 UNKT-ja – në bashkëpunim me qeverinë e Kosovës dhe partnerët dhe palët e tjera relevante të interesit – do të vazhdojë zbatimin e Kornizës së vet për Bashkëpunim, me fokus të rigjallëruar në fushat prioritare vijuese:



Skano për më shumë



### Agjenda Të Mos Lëmë Askënd Prapa

program arti, shfaqjesh dhe eventesh. Duke punuar me partnerët, OKB-ja do të kontribuojë në zhvillimin e hapësirave të gjelbra dhe publike, integrimin e lagjeve të izoluara dhe opsionet e transportit të pastër, me pjesëmarrjen maksimale të qytetarëve.

161. Integrimi i të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore në strategjitë dhe politikat zhvillimore të Kosovës, ndërtimi i kapaciteteve lokale për zbatim, veçanërisht në lidhje me të drejtat e fëmijëve, migrantëve, të mbijetuarve të dhunës në familje dhe personave me aftësi të kufizuara, si dhe mbështetja e politikave që synojnë mbrojtjen e


grupeve më të cenueshme dhe promovimin e kohezionit social, duke përfshirë mbulimin universal shëndetësor, ofrimin e shërbimeve të integruara sociale, nxitjen e dygjuhësisë dhe forcimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrjen komunale.

162. Mbështetja e aspekteve të tranzicionit të gjelbër të Kosovës, duke përfshirë forcimin e ekonomisë qarkore, rritjen e veprimit lokal dhe institucional për klimën, ndërtimin e kapaciteteve të Këshillit të Kosovës për Ndryshimet Klimatike dhe kontributin në përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave në kujdesin shëndetësor.

promovimi i skemës qeveritare të Garancisë për Rininë), përdorimi i të rinjve dhe grave si **agjentë të ndryshimit** për të ndërtuar kohezionin social dhe për të promovuar buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.

165. Vazhdimi i mbështetjes për qeverinë për rindërtimin më të mirë dhe ndërtimin për të ardhmen, me një fokus të veçantë në:

- Forcimin e qëndrueshmërisë së sistemit shëndetësor dhe rritjen e disponueshmërisë, qasjes, cilësisë dhe ekuitetit të shërbimeve shëndetësore.
- Adresimin e shkaqeve rrënjësore që prekin grupet më të cenueshme, duke siguruar që zbatohen masa për t'u përgatitur më mirë dhe për t'u përgjigjur krizave të ardhshme.



### Fushat strategjike të bashkëpunimit të përbashkët të OKB-së

159. Mbështetja për qeverinë për finalizimin e **Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2030 dhe të strategjive sektoriale**, duke siguruar integrim të mbarë të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, veçanërisht në lidhje me **gjenerimin e të dhënave dhe politikat e bazuara në dëshmi**, si dhe lokalizimin përmes proceseve të Shqyrtimit Vullnetar Lokal.

160. Anëtarët e UNKT-së do të angazhohen plotësisht për të mbështetur **bienalen Manifesta**, e cila do të vijë në Prishtinë nga korriku deri në shtator 2022 me një



### Nxitja e potencialit të të rinjve dhe grave dhe vajzave

163. Mbështetja e transformimit digjital duke përfshirë ndërtimin e kapaciteteve institucionale për **monitorimin e shëndetit, ofrimin e vaksinave, përputhjen e punësimit** për punëkërkuarit dhe zbatimin e regjistrimit.

164. Promovimi i **barazisë gjinore**, lehtësimi i **përfshirjes ekonomike**, kontributi për **çrrënjosjen e dhunës** ndaj grave dhe vajzave, dhe **rritja e pjesëmarrjes**, duke përfshirë edhe shkathhtësitë e përmirësuar (edukimi në fëmijërinë e hershme; programe të bazuara në shkathhtësi; mundësi për trajnim dhe praktikë;







166. Mbahen dhe zgjerohen partneritetet për zbatimin dhe financimin e prioritetëve të lartpërmendura, veçanërisht duke punuar me partnerët e qeverisë për të **forcuar** sistemet për qasje cilësore dhe gjithëpërfshirëse në shërbime dhe fuqizimin e qytetarëve për të kërkuar të drejtat e tyre. Paralelisht, vazhdojmë angazhimin dhe **partneritetet strategjike me sektorin privat, shoqërinë civile, akademinë**, dhe përmirësojmë bashkëpunimin me institucionet financiare zhvillimore (**IFZH**), mbahen partneritete me bankat shumëpalëshe zhvillimore (**BSHZH**) dhe institucionet financiare ndërkombëtare (**IFN**), veçanërisht me Bankën Botërore për çështjet e reziliencës dhe brishtësisë, dhe fokusimi në **forcimin e institucioneve dhe bashkëpunimit jug-jug, trekëndor dhe rajonal**.
167. Promovimi i pronësisë dhe angazhimit të të gjitha palëve të interesit për arritjen e OZHQ-ve; eksplorimi i opsioneve të financimit; përmirësimi i strategjive për financim të qëndrueshëm dhe të integruar dhe investimeve; shfrytëzimi i potencialit të inovacioneve financiare, teknologjive të reja dhe digjitalizimit për të ofruar qasje me ekuitet në financa; dhe, në bashkëpunim me qeverinë e Kosovës dhe partnerët përkatës zhvillimorë dhe IFN-të, synohet avancimi i **Fondit të Mirëbesimit për OZHQ-të**. Ndikimi i opinionit publik dhe angazhimit të shoqërisë civile nëpërmjet avokimit të përbashkët.

168. Punë nga afër me familjen e Kombeve të Bashkuara në mbarë Ballkanin Perëndimor, duke bashkëpunuar në fusha me interes dhe nevoja të përbashkëta, dhe së bashku lehtësohet **shkëmbimi i njohurive dhe përvojës** për të përshpejtuar nxjerrjen e mësimëve dhe arritjet e përgjithshme. Prodhoen, përdoren dhe shpërndahen të dhëna relevante. Koordinim i përpjekjeve për të avancuar mundësitë në mbarë Ballkanin Perëndimor për nisma të përbashkëta për dialogun, ndërtimin e besimit, kohezionin social dhe shoqëritë gjithëpërfshirëse, në konsultim të ngushtë me qeveritë dhe palët e tjera të interesit në të gjithë nën-rajonin dhe në bashkëpunim me Fondin e Kombeve të Bashkuara për Ndërtimin e Paqes.
169. Secila prej këtyre fushave të fokusit do të funksionalizohet përmes Planeve të Përbashkëta të Punës për vitin 2022 dhe do të mbikëqyret përmes grupeve relevante të rezultateve. Progresi i zbatimit dhe rezultatet do të pasqyrohen online në UN INFO, në raportet vjetore të progresit, në shqyrtimet gjastëmujore dhe/ose vjetore, si dhe në raportet e donatorëve dhe rrjetet sociale. Raportet dhe vlerësimet e të drejtave të njeriut do të kryhen rregullisht dhe do të ofrojnë pasqyra të përditësuara të situatës së të drejtave të njeriut në Kosovë dhe veprimeve të informuara të UNKT-së, në bashkëpunim me UNMIK-un, institucionet e Kosovës dhe partnerët zhvillimorë.

**Rezultatet e UNKT-së për vitin 2021 janë arritur në bashkëpunim me:**

**Partnerë dypalësh**

Agjencia Austriake për Zhvillim  
Këshilli Danez për Refugjatët  
Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit  
Qeveria e Austrisë  
Qeveria e Kanadasë  
Qeveria e Danimarkës  
Qeveria e Finlandës  
Qeveria e Gjermanisë  
Qeveria e Italisë  
Qeveria e Japonisë  
Qeveria e Luksemburgut  
Qeveria e Norvegjisë  
Qeveria e Republikës së Koresë  
Qeveria e Suedisë  
Qeveria e Zvicrës  
Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar  
Qeveria e SHBA  
Helvetas  
Agjencia Suedeze për Bashkëpunim për Zhvillim Ndërkombëtar  
Bashkëpunimi Zviceran për Zhvillim USAID

**Partnerë shumëpalësh**

Këshilli i Evropës  
EULEX  
Bashkimin Evropian  
Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq  
KFOR  
OSBE

**Partnerë të tjerë ndërkombëtarë**

Oda Ekonomike Austriake  
Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit  
Iniciativa e Partneritetit  
Manifesta International – Bialja Nomade Evropiane  
Terre Des Hommes

**Banka dhe Fonde Zhvillimore**

Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës  
Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim  
Banka Evropiane e Investimeve  
Fondi Evropian i Investimeve  
GAVI, Aleanca për Vaksinën  
Instrumenti Global i Mjedisit  
Partneritete Globale për Ujin  
Grupi i Bankës Botërore  
Organizata Botërore e Doganave

**Shoqëria civile**

Veprim për Nënën dhe Fëmijët (AMC)  
Avancojmë së bashku  
Qendra e Avokimit për Kulturë Demokratike Aktiv  
Klubi Alpin Prishtina  
Artpolis - Qendra për Art dhe Komunitet  
Asociacioni i Direktorëve të Biznesit  
Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës  
Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës  
Asociacioni i Institucioneve Parashkollore Private - APPI  
Asociacioni i Bashkësive Fetare  
Shoqata e Grave të Policisë së Kosovës  
Shoqata për Edukim dhe Zhvillim të Shëndetësisë – AHED  
BIRN  
Balkan Sunflowers Kosova -BSFK  
Bethany Christian Services -BCS  
CACTTUS  
Caritas Kosova  
Bashkësia Katolike e Kosovës  
Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime  
Qendra për Demokraci dhe Shoqëri Civile - CDCS  
Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave  
Qendra për Politika dhe Avokim - CPA  
Qendra për Nisma Sociale  
CIVIKOS  
Qendra për Shërbime Humane dhe Zhvillim - QSHHZH  
Programi për të Drejtat Civile në Kosovë  
Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF  
Programi i Rehabilitimit të Bazuar në Komunitet Ndërtimi i Komunitetit Mitrovicë  
Zhvillohemi së bashku  
Dokufest  
Domovnik  
Instituti i Evropës Lindore për Shëndetin Riprodhues  
Rrjeti për Politika të Informuara me Dëshmi  
Qendra Evropiane për Çështjet e Pakicave - ECMI  
Fortesa  
Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multi-etnik  
GERMIN  
HANDIKOS  
Shëndet për të gjithë  
Instituti për Hulumtim dhe Zhvillim të Arsimit  
IADK  
INDEP  
Qendra e Inovacionit të Kosovës



<p>Internews Fondacioni IPKO Fondacioni Jahjaga J-Coders JETA/VITA Kallxo.com Iniciativa Kosovare për Stabilitet - IKS Oda e Avokatëve të Kosovës Qendra për Arsim e Kosovës Qendra Kosovare për Studime Politike Rrjeti CSR Kosova Instituti Demokratik i Kosovës Forumi i Kosovës për Aftësinë e Kufizuar Qendra Kosovare për Studime Gjinore Fondacioni për Popullsinë e Kosovës Rrjeti i Grave RAE të Kosovës Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës Kryqi i Kuq i Kosovës Portali Kosovo Sever Rrjeti i Grave të Kosovës Këshilli Rinor i Kosovës Labirint Shoqata e Avokatëve NORMA LENS Fondi për Zhvillim Lokal LoCAF Forumi Lokal i Veprimit për Klimën Medica Gjakovë Medica Kosovë Fondacioni i Mijëvjeçarit në Kosovë Organizata e Prindërve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara në Kosovë Bashkësia Ortodokse e Kosovës PAX Shoqata për të Drejtat e Pacientëve në Kosovë – PRAK Rrjeti i Kolegëve Edukatorë - PEN Përmes Artit ne Krijojmë-PANK (kolektiv artistik) Oda e Farmacistëve të Kosovës Q'Art (kolektiv artistik) Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror - OFAP</p>	<p>Lobi Rajonal i Grave për Paqe, Siguri dhe Drejtësi në Evropën Juglindore Shoqata e Prindërve "Podrzi me" Instituti për Hulumtime Zhvillimore Riinvest Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor – RYCO Romët në Veprim Shtëpia e Sigurt Gjakovë Sabor në Graçanicë Santa Maria, Caritas Kosova Strehimore Liria Shko-PA-M'Sha Shnergjia SIT - Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime Programi i SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë Terre des Hommes Zvicër Fondacioni Utalaya Women2Women Lëvizja YMCA Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut</p> <p>Sektori Privat dhe Banka ING Bank Shoqata e Bankave të Kosovës KoSSev Raiffeisen Bank</p> <p>Institucionet e Kosovës Akademia e Drejtësisë Agjencia për Ndhimë Juridike Falas Agjencia për Barazi Gjinore Agjencia e Regjistrimit Civil Agjencia Kundër Korrupsionit Qendra e Azilit Policia e Kufirit Qendrat për Punë Sociale Komisioni për Verifikimin dhe Njohjen e Statusit të të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale të Lidhur me Konfliktin</p> <p>Kuvendi i Kosovës dhe komisionet përkatëse: Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë,</p>	<p>Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm Grupi i Grave Deputete Grupi i Gjelbër i Deputetëve Asociacioni i Komunave të Kosovës Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar Agjencia e Rregullatore Barnave dhe Oda e Farmacistëve Agjencia e Menaxhimit Emergjent Agjencinë e Punësimit të Kosovës Sistemi Informativ i Menaxhimit të Punësimit Agjencia për Mbrotjtjen e Mjedisit Njësia për Inteligjencë Financiare Kontabiliteti Forenzik dhe Vërtetimi i Mashtrimit Financiar Autoriteti Qeveritar për Migracionin Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur Grupi për Studime Juridike dhe Politike Sistemi Informativ Shëndetësor Instituti Hidro-Meteorologjik Agjencia për Shoqëri të Informacionit Instituti i Shëndetësisë Publike Instituti i Mjekësisë Ligjore Këshilli Gjyqësor Agjencia për Akreditim e Kosovës Agjencia e Kosovës për Forenzikë dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës</p>	<p>Agjencia e Statistikave të Kosovës Bordi i Kosovës për Kontrollin e Kancerit Agjencia Kadastrale e Kosovës Oda Ekonomike e Kosovës Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës Komisioni i Kosovës për Ndryshimet Klimatike Komisioni i Kosovës për Auditim të Brendshëm Këshilli Ekonomik dhe Social i Kosovës Qendra për Arsim e Kosovës Fondi i Punësimit i Republikës së Kosovës Agjencia e Pyjeve të Kosovës Instituti i Kosovës për Administratë Publike Këshilli Gjyqësor i Kosovës Instituti Gjyqësor i Kosovës Policia e Kosovës Këshilli Prokurorial i Kosovës Forca e Sigurisë së Kosovës Inspektorati i Punës Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Prishtinë Fondacioni i Mijëvjeçarit në Kosovë Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Ministria për Komunitete dhe Kthim Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Ministria e Arsimit dhe Shkencës Ministria e Ekonomisë Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor, Transportit dhe Infrastrukturës Ministria e Financave Ministria e Punëve të Jashtme Ministria e Shëndetësisë Ministria e Punëve të Brendshme Ministria e Drejtësisë Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve Ministria e Pushtetit Lokal Ministria e Administratës Publike Ministria e Tregtisë dhe Industriës</p>	<p>Mekanizmat Koordinues Komunalë për Dhunën në Familje Programi Zhvillimor Komunal Drejtoritë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale Drejtoritë Komunale të Arsimit Zyra Komunale e Gjendjes Civile Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim Komuna e Dragashit Komuna e Ferizajit Komuna e Fushë Kosovës Komuna e Gjakovës Komuna e Gjilanit Komuna e Graçanicës Komuna e Istogut Komuna e Kaçanikut Komuna e Kamenicës Komuna e Leposaviqit Komuna e Lipjanit Komunën e Malishevës Komuna e Mitrovicës së Veriut Komuna e Mitrovicës së Jugut Komuna e Obiliqit Komuna e Pejës Komuna e Prishtinës Komuna e Prizrenit Komuna e Skënderajit Komuna e Vushtrrisë Komuna e Rahovecit Komuna e Zubin Potokut Komuna e Zveqanit Zyra e Kryeprokurorit Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështjet Gjinore Zyra e Komisionerit të Gjuhëve Zyra e Prokurorëve Specialë Zyra e Prokurorit Disiplinor Zyra e Koordinatorit Nacional për Dhunën në Familje Zyra e Kryeministrit Zyra për Planifikim Strategjik e Kryeministrit Institucioni i Avokatit të Popullit Institucioni i Hapur Edukativ Korrektues Shërbimet Publike të Punësimit Radio Televizioni i Kosovës Programi i Trajnimit për Akademinë e Drejtësisë Administrata Tatimore Qendra Klinike Universitare e Kosovës Universiteti për Biznes dhe Teknologji Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Edukimit - Fakulteti Filologjik - Instituti i Psikologjisë Qendra e Aftësisë Profesionale</p>
---	--	--	--	--



United Nations  
Kosovo Team, 2022

[www.kosovoteam.un](http://www.kosovoteam.un)

[facebook.com/UNKosovo](https://facebook.com/UNKosovo)

[twitter.com/UN\\_Kosovo](https://twitter.com/UN_Kosovo)

[www.instagram.com/un\\_](https://www.instagram.com/un_)

